

Raiffeisen Bank Albania

Raport Vjetor 2011

Përmbajtje

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues	108
Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm	109
Misioni	110
Perspektivat dhe Planet për vitin 2012	111
Raporti i Bordit Drejtues	114
Zhvillimet ekonomike	114
Rezultatet Financiare	115
Raporti i Segmenteve	122
Segmenti Korporatë	122
Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve	124
Divizioni i Produkteve	126
Divizioni i Zhvillimit të Rrjetit	127
Kanalet e Shpërndarjes	129
Thesari dhe bankingu i Investimeve	132
Të ardhurat fikse	132
Tregu i parasë	132
Këmbimi valutor	133
Shitjet e thesarit	133
Përgjegjësi Sociale	136
Burimet Njerëzore dhe Trajnimet	138
Raporti i Auditorit të Pavarur	144
Raiffeisen Leasing	188
Rreth Raiffeisen Invest sh.a	190
Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen	192
Një vështrim mbi Raiffeisen Bank International	194
Rrjeti i Raiffeisen Bank SHA	198
Adresa dhe Kontakte	199
Fjalori Raiffeisen	202



Antarët e Bordit Drejtues të Raiffeisen Bank SHA:

John McNaughton

Antar Bordi për Retail

Alexander Zsolnai

Zëvendës Drejtor i Bordit Drejtues

Raphaela Bischof-Rothauer

Antar Bordi për Operacionet dhe TI

Christian Canacaris

Drejtor i Përgjithshëm

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues


Zonja dhe zotërinj,

Viti 2011 ishte përsëri një vit mjaft i rëndësishëm. Zhvillimet në Evropë, dhe veçanërisht në shtetet periferike të eurozonës, lanë gjurmët e tyre ndaj grupit të kryesuar nga Raiffeisen Bank AG International (RBI), kompania mëmë e Raiffeisen Bank. Ndërsa ekspozimi ynë ndaj këtyre shteteve ishte tradicionalisht i ulët dhe ne nuk u prekëm direkt, përsëri nuk arritëm që t'u shpëtonim efekteve të mjedisit të tregut pas krizës së përgjithshme të borxhit sovran.

RBI dhe bankat në përgjithësi po përballen me shumë rregulla të reja. Sipas mendimit tonë, megjithatë, ato janë paraqitur në një kohë të pafavorshme dhe me shumë nxitim. Rregullat u publikuan nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA) në fund të tetorit, kërkesa e të cilit për një normë të kapitalit themelor (core tier capital) prej 9 për qind deri në fund të qershorit 2012 ushtroi presion mbi shumë banka në Evropë. Megjithatë, ne - për të qenë më të saktë, Grupi RZB - është i mirë pajisur për ta realizuar këtë kërkesë. Ne kemi miratuar një paketë të plotë të masave, i përbërë nga masa të shumta individuale. Ne jemi edhe në një pozitë të mirë për të nxjerrë fitime, të cilat po e forcojnë kapitalin tonë. Si rezultat, ne mund t'i plotësojmë kërkesat e reja përmes burimeve tona.

Duke realizuar normën e caktuar nga EBA, RBI po përmbush gjithashtu normën prej 7 për qind të Basel III, të cilën rregullatorët austriakë e kanë caktuar si të detyrueshme më herët se sa ishte planifikuar më parë, pra nga fillimi i 2013. Për më tepër, rregullatorët austriakë zbatuan një sistem norme për bankat që veprojnë në Evropën Qëndrore dhe Lindore për të ekuilibruar fondet nga burime të tjera, përveç atyre nga aksionet dhe kreditë. Ne nuk e konsiderojmë si një kufizim të madh udhëzimin që për çdo 100 € të depozitave duhet të huazohen vetëm 110 € (duke përfshirë edhe disa forma të tjera të financimit). Meqënëse rritja e kreditimit është e lidhur me rritjen ekonomike, ka të ngjarë që ajo të jetë e moderuar në vitet e ardhshme. Ndërsa shikojmë ritmet e rritjes, ne duhet të bëjmë dallimin ndërmjet tregjeve. Ndërsa në eurozonë ne po përballemi me një krizë të vërtetë politike dhe në sistem, në Evropën Qendrore dhe Lindore rritja ekonomike vazhdon të jetë e qëndrueshme. Ky rajon është dhe do të vazhdojë të jetë nxitësi i rritjes ekonomike për Evropën. Edhe në qoftë se rritja ekonomike në rajonin e CEE ngadalësohet nga 3.7 për qind në vitin 2011 në 2.6 për qind në vitin 2012, kjo është ende më e lartë se sa në eurozonë. Ky nuk është një parashikim i keq për ne.

Në këtë ambient të vështirë, Grupi RBI nxorri një fitim para taksave prej 1.37 miliard €, i cili është një rezultat solid me të cilin ne me të drejtë mund të krenohemi. Ajo që e mundësoi këtë fitim është fakti se tregjet në Evropën Qendrore dhe Lindore vazhdojnë të tregojnë një rritje relativisht të lartë ekonomike, e cila gjithashtu ka rezultuar në një përmirësim të dukshëm të situatës sonë të riskut. Rezultati ynë konfirmon modelin tonë të qëndrueshëm të biznesit, i cili do të vazhdojë të na mbajë shumë konkurrues!



Heinz Hödl
Kryetar i Këshillit Drejtues

Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm

Me kënaqësi ju njoftoj se Banka Raiffeisen e ka mbyllur me sukses vitin financiar 2011.

Jam veçanërisht krenar për këtë, sepse viti 2011 ishte një vit i vështirë dhe me mjaft sfida. Megjithatë ne i arritëm dhe tejkaluam objektivat tona të fitimit, rritëm dhe konsoliduam më shumë pozicionin numër një në të gjithë treguesit kryesorë me kontributin e të gjithë segmenteve të biznesit. Tani ne jemi gati për 2012.

Depozitat tona u rritën me 17.6 përqind krahasuar me vitin 2010 dhe arritën në 2 miliardë Euro duke na lënë në këtë mënyrë mjaft hapësirë për të kredituar ekonominë.

Jemi banka së cilës i besojnë më shumë se gjysmë milionë klientë në mbarë vendin, të cilëve u ofrojmë një gamë të gjerë produktesh kursimi, kredie, M-Banking.

Kompanitë dhe individët treguan shenja pozitive për huamarrje duke rritur kërkesën për likuiditete, kërkesë e cila u plotësua nga Banka Raiffeisen. Ne rritëm ndjeshëm huatë si për korporatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Kreditdhënia ndaj kompanive të mëdha u rrit me 34.1 përqind në 606 milionë Euro, gjë që tregon zhvillimin ekonomik. Si rrjedhojë, asetet (kreditë) tona në total u rritën me 25.3 përqind në 970 milion Euro. Niveli ynë i likuiditetit, i cili matet nga raporti kredi/depozita, vazhdoi të ishte i qëndrueshëm në 48.2 përqind, që do të thotë që dhe kreditdhënia dhe depozitat u rritën. Likuiditeti jonë bëri të mundur të investonim në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare, duke e ndihmuar në këtë mënyrë edhe më shumë ekonominë e vendit.

Kriteret e menaxhimit të riskut u morën në konsideratë dhe u vlerësuan në mënyrë të vëmendëshme për të siguruar një cilësi të lartë portofoli.

Në fokusin tonë vazhdoi të mbetej përmirësimi dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve dhe produkteve që ofrojmë për klientët tanë. Gjatë vitit 2011 ne hodhëm në treg për herë të parë M-Banking, një shërbim krejtësisht i ri dhe inovator për tregun shqiptar i cili u mirëprit nga një pjesë e konsiderueshme e klientëve tanë.

Raiffeisen Leasing vazhdoi të mbetej një zgjedhje mjaft e pëlajshme për kompani dhe individë që donin të financonin makineri, pajisje, automjete për transport mallrash dhe makina. Raiffeisen Leasing zë vendin e parë në tregun e lizingut në Shqipëri.

Raiffeisen Invest është kompania e parë dhe e vetme në treg që mori licencën për tregtimin e fondeve të investimit ndërsa Raiffeisen Pensions pati një vit financiar të shkëlqyer me gamën e produkteve të pensionit që ofron.

2012-ta do të jetë një vit me mjaft sfida. Ne do të na duhet të punojmë shumë për të arritur objektivat tona. Por ne jemi gati të përballemi me zhvillimet e reja, punonjësit tanë janë të trajnuar, të fokusuar, dhe të vendosur për ta parë Bankën Raiffeisen në pozicionin numër një në sektorin bankar në vend. Unë kam besim tek ata dhe e di se viti 2012 do të jetë një tjetër vit i suksesshëm për të gjithë ne. Ne do të bëjmë ndryshimin duke ofruar produktet dhe shërbimet më të mira, në mënyrën më të mirë nga profesionistët më të mirë.



Christian CANACARIS
Drejtor i Përgjithshëm
Kryetar i Bordit Drejtues

Misioni

Ne rrisim standartet bankare dhe bëjmë ndryshimin në jetën e konsumatorit duke ofruar produkte konkurruese dhe shërbime me cilësinë më të mirë.

Ne kërkojmë marrëdhënie afatgjata me klientët.

Si anëtare e Raiffeisen Bank International, ne bashkëpunojmë ngushtë me RBI-në dhe me antarët e tjerë të grupit.

Ne arrijmë një kthim mbi kapitalin të qendrueshëm dhe mbi mesataren.

Ne i japim mundësi punonjësve tanë të jenë sipërmarrës, të tregojnë iniciativë dhe nxisim zhvillimin e tyre.

Perspektivat dhe Planet për vitin 2012

Pas sfidave të vitit 2011 Banka Raiffeisen vazhdon të rritet dhe t'i ofrojë më shumë ekonomisë së vendit. Konkurrenca do të mbetet e lartë në vitin 2012, por ne e dimë se çelësi i suksesit tonë është afrimi me klientët dhe bashkëpunimi me ta për t'ia dalë mbanë në këtë mjedis sfidues, ndërkohë që do të vazhdojmë investimet në produkte, shërbime dhe teknologji të reja.

Cilësia e shërbimit ndaj klientit në të gjitha segmentet tona do të vazhdojë të jetë përparësi. Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve, përmirësimi i efikasitetit, proceset e thjeshtësuara dhe një akses gjithmonë e më i përshtatshëm nëpërmjet kanaleve të shpërndarjes do të ndihmojnë për të arritur këtë qëllim.

Si Banka me kredithënien më të lartë në Shqipëri ne synojmë ta ruajmë këtë pozicion në vitin 2012, duke e vënë theksin në veçanti të rritja e cilësisë së portofoleve të ndryshme të kredive. Një rëndësi e veçantë do t'i jepet rritjes së segmenteve tona të biznesit, duke filluar nga klientët Individë, Mikro, Bizneset e Mesme dhe deri te ata Korporatë.

Në segmentet e biznesit Korporatë do të vazhdojmë të fokusohemi jo vetëm te kreditë, por edhe te ofrimi i një gamë të gjerë shërbimesh bankare si për bizneset ashtu edhe për punonjësit e tyre. Zgjerimi i shërbimeve të bankingut elektronik do të vazhdojë të mbetet përparësi në vitin 2012 dhe ne gjithashtu do të hedhim në treg produkte dhe shërbime risi.

Banka do të vazhdojë t'u ofrojë klientëve produkte të shkëlqyera depozitash dhe kursimesh nëpërmjet kushteve të reja dhe interesave mjaft tërheqëse. Gama e këtyre produkteve tashmë u është shtuar edhe Fondi Prestigj i cili është një mundësi shumë e mirë investimi nëpërmjet Raiffeisen Invest, i tregtueshëm në të gjithë rrjetin e degëve të Raiffeisen Bank.


Bankingu elektronik për bizneset dhe klientët Individë u jep atyre fleksibilitet maksimal dhe mënyra të ndryshme për t'i kryer transaksionet bankare nëpërmjet telefonit celular kudo dhe në çdo kohë. Rrjeti i degëve vazhdon të përmirësohet me standardet e reja të cilat janë duke u zbatuar, si edhe me zhvendosjen e disa degëve në vende më të mëdha dhe më të përshtatshme për t'u ofruar klientëve tanë një shërbim më të mirë.

Bordi Drejtues i Bankës Raiffeisen dëshiron të falënderojë sinqerisht të gjithë klientët dhe partnerët e saj të biznesit për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre gjatë vitit 2011. Jemi plotësisht të përkushtuar për të përbushur kërkesat tuaja bankare dhe për t'ju ofruar një shërbim të cilësisë së lartë në çdo pikë takimi që ju keni me Bankën.

Ne kemi besim që do të mbetemi zgjedhja e parë për ju edhe gjatë vitit 2012!



Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai
Zëvendës Drejtor i
Bordit Drejtues



Raphaela Bischof
Antar Bordi për
Operacionet & TI



John McNaughton
Antar Bordi për Biznes Retail





Vëmendje e veçantë i është dhënë zonës veriore të Shqipërisë. Në fokusin e departamentit të sponsorizimeve kanë qenë të gjitha fushat e mundshme; edukim, shëndetësi, kulturë dhe sport.

Raporti i Bordit Drejtues

Zhvillimet ekonomike

Efektet e krizës të ekonomive rajonale, Greqisë dhe Italisë u ndjenë plotësisht gjatë vitit 2011. Situata e tensionuar politike që nisi me ngjarjet tragjike të Janarit ku humbën jetën 4 protestues të opozitës dhe u mbyll me refuzimin dhënies të statusit kandidat të Shqipërisë nga ana e Komisionit Europian, ndikuan në përkeqësimin e situatës ekonomike.

Ekonomia shqiptare ndonëse u rrit gjatë vitit 2011, pati performancën më të dobët që nga viti 1997 duke shënuar një rritje ekonomike rreth nivelit 2.6% nga viti në vit për tremujorin e tretë të 2011.

Rritja e ulët e PBB erdhi si faktor i uljes së kërkesës së brendshme, rënies së nivelit të remitancave prej -8.6%, në nëntë muajt e parë të vitit, duke ndikuar direkt në uljen e fuqisë blerëse.

Gjithashtu mosbesimi i investitoreve për shkak të krizës së rëndë të ekonomive rajonale si edhe klimës të përkeqësuar ekonomike solli edhe rënien e Investimeve të Huaja Direkte në nivelin -25% nga viti në vit gjatë nëntë muajve të parë të vitit.

Ndikimin pozitiv në rritjen e PBB për tremujorin e tretë të vitit 2011 e kishin sektorët; Transport +19.7%, Shërbimet dhe Tregtia me 6.2% dhe Industria përpunuese me 4.8%.

Defiçiti tregtar u përkeqësua me 16.8% krahasuar me vitin 2010 si pasojë e rënies të eksportëve me vendet fqinje Greqi, Itali si edhe me përkeqësimin e situatës hidrike e cila rriti nevojën për importim të energjisë elektrike. Tregtia me Greqinë dhe Italinë, të cilat kanë qenë historikisht partnerët kryesorë tregtarë, u përkeqësua ndjeshëm gjatë vitit 2011. Niveli i eksporteve ndaj këtyre vendeve përbënte 57% ndaj totalit të përgjithshëm të eksporteve, krahasuar me 77% që ishte ky nivel përpara fillimit të krizës.


Niveli i inflacionit për vitin 2011 ishte brenda objektivit prej 2-4% të vendosur nga Banka e Shqipërisë. Pavarësisht rritjes që pësoi indeksi i çmimeve në tregjet rajonale dhe botërore, gjë që u pasqyrua me rritjen e inflacionit në Shqipëri mbi nivelin 4% në pesë muajt e parë të vitit, situata u përmirësua në gjashtë mujorin e dytë të vitit dhe inflacioni u ul në nivele poshtë 2%.

Niveli mesatar i inflacionit për vitin 2011 ishte 3.45%.

Me nivelin e inflacionit nën kontroll, Banka e Shqipërisë uli dy herë brenda vitit normën bazë të interesit. Aktualisht norma bazë e interesit është 4.5% duke qënë kështu vlera më e ulët e 10 viteve të fundit. Kjo politike e Bankës së Shqipërisë u ndërmorr me qëllim që të ulët kostoja parasë dhe të rritet vëllimi i investimeve në ekonomi, gjë e cila do të kishte si pasojë rritjen e qarkullimit të parasë, rritjen e nivelit të konsumit të brendshëm dhe duke ndikuar kështu në rritjen e PBB.

Përsa i përket kursit të shkëmbimit valutor, pozicioni i Lekut ishte i qëndrueshëm kundrejt Euros dhe Dollarit për shkak të nivelit të ulët të kërkesës duke mbetur në të njëjtat nivele me ato të vitit 2010.


Rritja Reale e PPB (ndryshimi vjetor në %)



Rezultatet Financiare


Totali i aktiveve në fund të vitit 2011 ishte 322,854 milion (2010: 277,984 milion). Në 2011 vazhdoi zgjerimi i mëtejshëm i portofolit të kredisë, i cili në fund të vitit 2011 përfaqësonte 38% (2010: 35%) të totalit të aktiveve të bankës. Investimet në letra me vlerë vazhdojnë të zënë pjesën më të madhe të totalit të aktiveve të bankës duke përfaqësuar rreth 45% të këtij totali në 2011 (2010: 48%).

Struktura e Bilancit - Aktivi (në '000 LEK)




Totali i huave dhe paradhënieve për klientët në fund të vitit 2011 ishte 134,992 milion lekë (2010: 107,676 milion lekë) duke përfaqësuar kështu një rritje prej 25% të portofolit të kredisë gjatë këtij viti. Sektori i Korporatave përfaqëson 66% të totalit të portofolit të kredisë dhe zuri vendin kryesor në këtë portofol me një tepricë kredisë prej 88,574 milion lekë (2010: 67,364 milion lekë). Segmentet e Ndërmarrjeve të Mesme shënuan një rritje në portofolin e kredisë përkatësisht 8%. U shënuan një rritje në portofolin e kredisë prej 33% për segmentin e ndërmarrjeve të vogla me një tepricë prej 4,593 milion lekë (2010: LEK 3,460 milion lekë).

Struktura e Hua dhe Paradhënie për klientët




Në 2011 portofoli i kredisë përbëhet kryesisht nga një kombinim i kredisë afatmesme prej 24% (2010: 20%) dhe paradhënies bankare prej 42% (2010: 47%). Kredia afatgjatë përfaqëson 23% të totalit të portofolit të Bankës për 2011 (2010: 21%).

Kredi gjatë vitit 2011
(në '000 LËK)




Totali i detyrimeve në fund të vitit 2011 ishte 322,854 milion lekë (2010: 277,984 milion lekë). Në 2011, pjesën më të madhe të detyrimeve e zënë depozitat e klientëve, të cilat përbëjnë rreth 86% (2010: 85%) të totalit të detyrimeve.

Struktura e Bilancit - Pasiv (në '000 LEK)




Ashtu si në 2010, profili i depozitave të klientëve tregon një tendencë të depozituesve për t'u larguar nga depozitat me afat të shkurtër maturimi. Me qëllim përfitimin nga interesat më të larta, klientët po investojnë kursimet e tyre në depozita me afat më të gjatë maturimi. Totali i depozitave të klientëve në fund të vitit 2011 është 223,977 milion lekë (2010: 188,593 milion lekë).

Struktura e Depozitave (në '000 LEK)




2011 shënoi një rritje 32 % të fitimit pas taksës në krahasim me 2010 në 7,085 milion lekë (2010: LEK 5,361 milion lekë) duke ndryshuar raportin e kthimit mbi kapitalin nga 23,45% në 2010 në 28,17% në 2011. Dividendi i deklaruar dhe i paguar në 2011 është 5,268 milion lekë (2010: 2,206) .

Struktura e Kapitalit Aksioner
(në '000 LEK)




E ardhura neto nga interesat u rrit me 3% ose nga 11,980 milion lekë në 2010, në 12,302 milion lekë në 2011. Rritja e të ardhurës nga interesat bashkë me rritjen e totalit të aktiveve të bankës prej 16%, ndikoi në përqesimin e kësaj të ardhure (llogaritur si raport i të ardhurës nga interesat mbi mesataren vjetore të totalit të aktiveve) duke e ulur atë me 42 pikë ose shprehur ndryshe nga 4.51% në 2010 në 4.1% në 2011.

Të ardhura neto
(në '000 LEK)




Shpenzimet administrative në total gjatë 2011 arritën në 1,911 milion lekë (2010: 1,578 milion lekë). Efienca operuese e Bankës – raporti kosto/të ardhura u përmirësua nga 31.8% në 35.35%.
 Shpenzimet për stafin u rriten me 8% ose 2,220 milion lekë në 2011 krahasuar me 2,041 milion lekë në 2010.

Shpenzime operative 2011
 (në '000 LEK)



Fitimi & ROE
 (në '000 LEK)



Duaje Tiranën, pedalo për një mjedis më të pastër!





**Raiffeisen
BANK**

Ky stacion u mundësua nga :

Fitoni çdo sfidë



Duke promovuar konceptin për një vend më të pastër dhe ekologjik, Raiffesien Bank ka sponsorizuar programin Ecovolis, Ecovolis - Biçikleta jote.

Raporti i Segmenteve

Segmenti Korporatë

Viti 2011 është një ndër vitet më të sukseshme për Segmentin Korporatë. Ky sukses reflektohet si në rritjen e ndjeshme në portofolin e kredive dhe të depozitave me respektivisht 31.9% dhe 22.1%, ashtu dhe nivelin e përfitueshmërisë, duke arritur fitimin më të lartë ndër vite.

Cilësia e portofolit është thelbësore prandaj ka pasur dhe do të ketë vëmendje dhe përkushtim maksimal si të forcës shitëse ashtu dhe të strukturave të menaxhimit të riskut. Kjo ka sjellë një përmirësim të treguesve cilësore të portofolit krahasuar me vitin 2010 ashtu dhe me treguesit mesatar të sistemit bankar për këtë segment.

Edhe gjatë vitit 2011 është mbajtur dhe përforcuar pozicioni kryesues në treg për këtë segment, duke shkuar nga në rreth 25% të totalit të kredive për këtë segment në sistemin bankar.

Jemi përpjekur që përveç përmirësimit dhe zgjerimit të shërbimit ndaj klientëve ekzistues të tërheqim pranë bankës dhe klientë të rinj, në mënyrë që të kemi një bazë klientësh gjithmonë e më të shëndetshme dhe reciprokisht të kontribuojmë në suksesin e përbashkët. Vetëm gjatë vitit 2011 në segmentin e korporatave kemi pasur një rritje të bazës së klientëve me rreth 6% krahasuar me vitin 2010.

Disa nga faktorët kryesor që kanë ndikuar në rezultatet e arritura janë:

1. Struktura me eficente
2. Ofrimi i produkteve të specializuara
3. Sinergji më e mirë me strukturat e tjera brenda bankës si dhe me bankat e tjera të grupit Raiffeisen Bank International.

Është e rëndësishme të theksojmë se Raiffesisen Bank ka privilegjin t'u shërbejë 1100 klientëve korporatë që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.

Ekspertët e Divizionit të Korporatave ofrojnë një spektër të gjerë produktesh, shërbimesh dhe zgjidhesh financiare, në përputhje me nevojat e bizneseve.

Konsolidimi i tregut për klientët korporatë që operojnë në Shqipëri ka kërkuar strukturimin e produkteve bankare të ofruara klientëve të këtij segmenti.

Realizimi me sukses i transaksioneve të strukturuar për financimin e projekteve në fusha të ndryshme, realizimi i disa kredive sindikate me banka të tjera në rolin e liderit, financimi i parë i një projekti jashtë kufijve të territorit të Republikës së Shqipërisë, na bën jo vetëm kryesues, por shpesh dhe pionier në sistemin bankar shqiptar.

Nga pikpamja e segmentimit të klientëve, Divizioni i Korporatave u shërben:

- Korporatat vendase të cilat operojnë në tregun shqiptar;
- Korporatat ndërkombëtare aktualisht prezente ose të interesuara të investojnë në tregun shqiptar;
- Institucionet Publike dhe të Pushtetit Qendror dhe Lokal;
- Institucionet Financiare jo-bankare.

Stafi i Divizionit Korporatë në sajë të eksperiencës disa vjeçare, është i gatshëm t'u sigurojë klientëve alternativën më të mirë bankare në Shqipëri duke garantuar besueshmëri, efektivitet, siguri dhe orientim drejt shërbimit ndaj klientit.

Sektori Publik

Përgjatë vitit është arritur të ndërtohen dhe të ruhen marrëdhënie të shkëlqyera midis Raiffeisen Bank dhe institucioneve publike. Banka ka ruajtur pozicionin kryesor në marrëdhëniet me Sektorin Publik nëpërmjet strategjive specifike, produkteve dhe shërbimeve si dhe sistemeve të komunikimit të dedikuara në përputhje me kërkesat e këtij sektori.

Banka Raiffeisen ka gjithmonë në fokus ruajtjen dhe kultivimin e mëtejshëm të një marrëdhënie partneriteti afatgjatë me të gjitha Institucionet Publike, Qendrore dhe Lokale. Si banka më e madhe në vend dhe partneri kryesor financiar

i Qeverisë Shqiptare, mban një peshë të rëndësishme për mbështetjen e projekteve publike nëpërmjet strategjive specifike, produkteve dhe shërbimeve bankare si dhe sistemeve të komunikimit të dedikuara në përputhje me kërkesat specifike të këtij sektori.

Divizioni i Produkteve Korporatë dhe Bizneseve të Vogla

Produktet e Menaxhimit të Likuiditeteve

Produktet dhe Shërbimet e Menaxhimit të Likuiditeteve janë pjesë e operacioneve bankare thelbësore për segmentin Korporatë dhe Biznese të Vogla. Produktet e Menaxhimit të Likuiditeteve lidhen me menaxhimin eficient të Likuiditeteve, të cilat janë të një rëndësie domethënëse si për klientët kombëtarë dhe ata ndërkombëtarë. Banka Raiffeisen është një nga bankat kryesore në vend përse i përket:

- ofrimit të një game të gjërë produktesh lidhur me menaxhimin e likuiditeve;
- përgatitjes dhe ofrimit e paketave sipas nevojave specifike të bizneseve;
- zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve sipas kërkesave të klientëve

Gjatë vitit 2011 njësia e Produkteve & Shërbimeve të Menaxhimit të Likuiditeteve është kujdesur për përditësimin e kushteve të punës, përmirësimin e produkteve egzistuese si dhe për hedhjen në treg të produkteve të reja, ku vlen të përmenden depozitat e kursimit dhe transfertat brenda rrjetit bankar të Grupit Raiffeisen International.

Financimi i Projekteve

Njësia e Financimit të Projekteve ka strukturuar disa projekte komplekse gjatë vitit 2011, duke ofruar për klientët korporatë një zgjidhje profesionale e cila i përshatet nevojave për financim. Eksperienca dhe përvoja e akumuluar gjatë kësaj periudhe ka ndikuar pozitivisht në zgjerimin e bashkëpunimit tonë edhe me institucione të tjera financiare të cilat shohin tek ne një partner të denjë për të bashkëpunuar.

Duke patur si synim kryesor përmbushjen e nevojave financiare të klientëve tanë, ne kemi organizuar dhe udhëhequr kredi të sindikuara vendase dhe të huaja (*cross border*) duke bashkëpunuar ngushtë me institucione financiare të mirënjohura si BERZH, KfW etj.

Të fokusuar në përfundimin me sukses të çdo projekti, cilësitë kryesore të cilat na dallojnë janë kreativiteti, kompetenca si dhe njohja e mirë e tregut të synuar.

Produktet e Financave Tregtare

Raiffeisen Bank sha ofron shërbimin e këshillimit të klientëve të saj për përdorimin e duhur të Transaksioneve të Financave Tregtare në mënyrë që të reduktojnë riskun e marrdhënieve tregtare me partnerët respektive ndërkombëtare dhe vendas. Ne i mbështesim klientët tanë për këto transaksione nëpërmjet një skuadre të dedikuar të krijuar në Divizionin e Produkteve të Korporatave dhe Bizneseve të Vogla që në vitin 2010. Krijimi i kësaj strukture, e cila qëndron shumë pranë klienteve ka ndikuar në një rritje të ndjeshme të volumeve tona gjatë vitit 2011.

Zhvillimi i Biznesit Korporatë dhe Bizneseve të Vogla

Njësia e Zhvillimit të Biznesit Korporatë dhe Bizneseve të Vogla e krijuar gjatë vitit 2011 ka si objektiv kryesor të saj përmirësimin e shërbimit të stafit të degës kundrejt klienteve të klasifikuar Korporatë dhe Biznes i Vogël. Stafi i dedikuar për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve për Biznesin Korporatë dhe Bizneseve të Vogla është i përqëndruar në degët dhe qytetet kryesore të Shqipërisë ku dhe prezenca e këtyre bizneseve është më e ndjeshme.

Nën këtë njësi është e pranishme dhe një skuadër e dedikuar e cila suporton klientët duke koordinuar dhe komunikuar me degët, agjensitë dhe me departamentet e tjera të bankës në mënyrë që të lehtësojë përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të klientëve të sipërpërmendur.

Segmenti i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme


Gjatë 2011-s, i kemi kushtuar vëmendje situatës së përgjithshme në tregjet financiare, duke u fokusuar kryesisht në kreditimet cilësore dhe shitjen e produkteve të depozitave. Gjithashtu, duke u bazuar në situatën e tregut të paraqitur në 2011, kemi ndryshuar strategjinë e segmentit tonë për vitet e ardhshme.

Raiffeisen Bank është e para bankë në Shqipëri e cila ka ndarë Bizneset e Vogla (segmentin mikro) dhe Kompanitë e Mesme në mënyrë që tu jepet më shumë kujdes secilit nga segmentet. Gjatë 2011 segmenti i Biznesit të Mesëm përmirësoi paketat e produkteve dhe kostove të shërbimeve bankare të cilat përipiqen të pasqyrojnë një prurje të Kompanive të Mesme pranë RBAL si dhe dizajnoi produkte të reja kredie.

Edhe për segmentin e ndërmarrjeve të mesme është aplikuar një strukturë e re e menaxhimit gjatë vitit 2011. Menaxherët e Marrëdhënieve me Klientin u ri-integruan nën administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme, veprim i cili reflekton fokusin e Bankës për këtë segment. Struktura mundësoi përgjigje të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë të nevojave të ndërmarrjeve të mesme.

Pavarësisht nga kushtet e tregut dhe të politikës së rishikuar të kreditimit, kemi financuar ndërmarrjet e mesme me kredi të reja për investime dhe për kapital punues në volumnin 32 milion euro, për një vlerë neto kredish në përdorim të kompanive të biznesit të mesëm në fund të vitit 2011 prej 102 milion euro.

Portofoli i Ndërmarrjeve të Mesme: Overdraft (Kredi Kufi) kundër Kreditë për Investim (kredi afatgjatë)



Në këtë vit, objektivi jonë ishte për të takuar më shpesh klientët tanë, për t'u siguruar që ne i njohim ata më në tërësi, dhe në mënyrë proaktive t'i këshillojmë se si të përballen me sfida të reja për aktivitetet e tyre. Ne vlerësojmë se një marrëdhënie e fortë profesionale me klientët e biznesit, është shumë e rëndësishme për bankën, për të kuptuar më mirë dinamikën e situatave të klientit, veçanërisht në sfidat e tyre për të përballuar kufizimet financiare dhe ekonomike gjatë vitit 2010. Nga ana tjetër, ne besojmë se klientët vetë, duhet të kenë partnerë të besueshëm dhe profesional, në mënyrë që të përfitojnë nga mbështetja e tyre në situata të vështira dhe të paparashikueshme financiare.

Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve

Segmenti i Klientëve Individë

Segmenti i klientëve individë gjatë vitit 2011 vazhdoi të rrisë numrin e klientëve me 8% duke arritur në rreth 640,000 klientë.

Mënyra moderne dhe e shpejtë e procesimit të pagave e kryqëzuar me fleksibilitetin e paketave tona të pagës kanë qenë avantazhet kryesore që kanë mundur rezultatet më të mira të tre viteve të fundit:

1. Rritja prej 22% e klientëve të rinj pagamarrës krahasuar me vitin e shkuar
2. 24% më pak klientë pagamarrës të larguar krahasuar me vitin e shkuar

Manaxhimi i Marrëdhënies me Klientin (CRM) i implementuar dhe prezantuar gjatë vitit 2010 vazhdoi të rrisë personalizimin dhe penetrimin e ofertave të shitjeve të kryqëzuara tek klientët tanë më të mirë edhe gjatë vitit 2011 duke rritur konsiderueshëm numrin e klientëve të kontaktuar.

Gjatë vitit 2011 ekipi i CRM organizoi 76 fushata të ndryshme, me synim kontaktimin e 289,500 klientëve. Klientët tanë reagojnë shumë mirë ndaj këtyre fushatave duke reflektuar këto rezultate:

1. 81% shitje të suksesshme nga fushatat e rinovimit të depozitave me afat
2. 25% e volumeve të reja të kreditë personale janë realizuar nga fushatat e CRM
3. 26% e kartave të kreditit të shitura gjatë vitit janë realizuar nga fushatat e CRM

Gjatë vitit 2012 Retail do të prezantojë konceptin e Ciklit të Jetës së Klientit Individ, i cili do të mbulojë produktet, shërbimet dhe paketat për të siguruar plotësimin e nevojave gjithnjë në rritje të klientëve.

Segmenti Premium


Shërbimi Premium vazhdon të ofrojë shërbime superiore bankare për klientët me vlerë të lartë duke garantuar që të gjitha nevojat, nga më minimalet tek ato më komplekset, të trajtohen me një përkujdesje të pakrahasueshme personale.

Në aktualisht kemi 29,000 klientë në segmentin Premium. Këta klientë janë të garantuar për marrjen e shërbimit të shkëlqyer në të gjitha degët tona dhe mund ta marrin këtë shërbim në zonat e dedikuara për shërbimin premium në 16 degët, ku menaxheri i shërbimit premium i ofron shërbim dhe këshillim të personalizuar financiar.

Asnjë bankë tjetër nuk ofron shërbimin Bankar Premium, e cila vazhdon t'i japë Bankës Raiffeisen një avantazh konkurrues të rëndësishëm në tërheqjen, ruajtjen dhe rritjen e shërbimeve që përdoren nga klientët premium.

Portofolet e segmentit premium u rriten fuqishëm gjatë vitit 2011, me depozita në nivel afro 900 mil Eur dhe vlerë të portofolit të kredive 17 mil Eur.

Në 2012 produkte të reja për investim dhe paketa të llogarive do t'i prezantohen klientëve Premium, duke rritur përfitimet që ata marrin, e kombinuar kjo me standarde të larta të shërbimit.



Segmenti Mikro

Gjatë vitit 2011 Segmenti Mikro ka vazhduar të rritet; rritje e cila reflektohet në Portofolin e Aktiveve me 32% dhe në Portofolin e Pasiveve me 20%. Aktivët kanë patur një rritje të theksuar gjatë gjysmës së parë të vitit. Deri në fund të 2011 portofoli i aktiveve ka arritur vlerën 30 milion dhe numri i klientëve të bizneseve të vogla është më shumë se 14,000.


Klienteve të Segmenti Mikro u shërbehet në të gjitha degët e rrjetit të bankës për nevojat e biznesit të tyre.

Gjithashtu ata kanë një staf të dedikuar prej 37 specialistësh shitjeje në 31 degë të rrjetit. Ata janë të kualifikuar në këshillim dhe shërbim biznesi.

Një arritje për këtë segment gjatë vitit 2011 ka qenë hedhja në treg e kredidhënies për bizneset bujqësore në Qershor 2011. Hyrja në këtë sektor strategjik dhe ofrimi i shërbimit dhe produkteve të specializuara do të rrisë avantazhet tona konkurruese në treg.

Në 2012 segmenti i bizneseve Mikro do të vazhdojë të fokusohet në forcimin e marrëdhënieve me klientet duke ofruar shërbim dhe produkte tërheqëse dhe konkurruese.

Total Asete & Numri i klienteve Mikro Janar - Dhjetor 2011



Divizioni i Produkteve

Depozitat

Viti 2011 ishte një vit shumë i rëndësishëm për sistemin bankar pasi depozitat patën një rritje të konsiderueshme dhe qëndrueshmëria në tregun shqiptar u konsolidua pavarësisht krizës së borxheve në Greqi dhe disa vende të tjera të Eurozonës. Depozitat për individë u rritën me më shumë se 21% gjatë 2011 krahasuar me një vit më parë, pasi ne u fokusuam në transparencë, në më shumë leverdisshmëri dhe çmime konkurruese. Si rezultat i kësaj, pjesa jonë e tregut u rrit me 80 pikë përqindje në 30,4% në Dhjetor 2011.

Me rritjen e bazës së depozitave tona, qëllim ynë i vazhdueshëm do të jetë sigurimi i volumeve të depozitave në përputhje me nevojat e bankës për likuiditet pa harruar përfitueshmërinë (nëpërmjet optimizimit të çmimeve).

Sistemi më bashkëkohor i depozitave u prezantua në Dhjetor 2010 dhe gjatë vitit 2011 u përmirësua në mënyrë të konsiderueshme. Ky fakt na ka lejuar të jemi lider në treg përse i përket fleksibilitetit dhe ofrimit të opsioneve të ndryshme për depozitat e klientëve tanë. Këtu përfshihet mundësia e zgjedhjes së opsionit të përfitimit të interesit në fillim, çdo muaj, çdo tre muaj, çdo gjashtë muaj apo çdo vit, rinovim automatik, apo opsioni i zgjedhjes së ri-investimit të interesit apo kalimit të tij palëve të tjera. Klientët gjithashtu mund të zgjedhin një datë të caktuar të maturimit të depozitës së tyre apo të kenë akses tek fondet e tyre në çdo moment. Për këtë opsion nuk ka anjë komision ose pagesë shtesë.

Nëpërmjet këtij sistemi u bë e mundur hedhja në treg e produktit promocional për fushatën e fundivitetit 2011, i cili ishte një risi në tregun shqiptar dhe i sapo prezantuar nga bankat e kursimeve lider në botë.

Skema e Kursimeve Raiffeisen, një produkt i ri cili u hodh në treg në fushatën e verës në 2011, u dizajnuar për të udhëhequr klientët drejt kursimit të vazhdueshëm e sistematik, duke krijuar në këtë mënyrë një bazë klientësh të qëndrueshëm për të ardhmen. Ne jemi e vetmja bankë që ofrojmë një nivel kaq të lartë fleksibiliteti në tregun shqiptar.

Kreditë

Tregu i kredive ka treguar qëndrueshmëri dhe një rritje të lehtë gjatë vitit 2011, dhe Raiffeisen Bank ka vazhduar të ketë pjesën më të madhe të tregut në volume të reja prej 28%. Ne vazhdojmë të rritemi dhe të mbajmë pozicionin lider në treg, duke arritur një rritje neto të konsiderueshme në totalin e portofolit të kredive. Raiffeisen Bank ofron gamën më të gjerë në treg të produkteve të kredive të siguara dhe atyre të pasiguara.

Përveç rritjes së fuqishme të shitjeve, viti 2011 u karakterizua nga përmirësime në aftësitë tona teknike dhe procesuese me prezantimin e një sistemi të ri aplikativ për të gjitha produktet e kredive retail. Ky fakt na lejoi të rrisim performancën tonë dhe ti ofrojmë një shërbim më të mirë klientëve tanë.

Gjatë 2011 fokus i veçantë iu dha biznesit të kredive hipotekore ku portofoli pati një rritje neto prej 26,9%. Kjo rritje në portofol u mundësua nga produktet e reja të hedhura në treg dhe opsioneve alternative që iu ofruan klientëve tanë, të mbështetura nga fushata marketingu të suksesshme si edhe nga rritja e ekspertizës së forcës së shitjes.

Raiffeisen Bank vazhdon të jetë lider në treg për kreditë e pasiguruara. Avantazhi ynë konkurrues kontribuoi në rritjen e pjesës sone së tregut në volume të reja me 14,3% gjatë 2011.

Kartat e Kreditit

Produkti i kartave të kreditit arriti një rritje të paparashikuar gjatë vitit 2011 duke përmbysur pritshmëritë e viteve të mëparshme. Numri i kartave të reja të lëvruara gjatë 2011 u rrit konsiderueshëm, duke rezultuar në një rritje prej 23% në pjesën tonë të tregut. Për më shumë, një rritje e rëndësishme u duk në volumin e transaksioneve të kryera me këto karta dhe si rezultat edhe në të ardhurat e gjeneruara prej tyre.

Kjo arritje u mundësua nga ofrimi i kartave me para-aprovim duke përdorur programe të avancuara CRM, të mbështetura nga përmirësime në kushtet e produktit dhe proceseve. Qëllimi ynë është të drejtojmë zhvillimin e një tregu të fortë të kartës së kreditit në Shqipëri.

Në 2012, Raiffeisen Bank do të vazhdojë të rrisë ndjeshëm produktin e kartës së kreditit si dhe promovimin e përdorimit të Pikave të Shitjes (POS).

Kartat e Debitit

Gjatë vitit 2011 vazhduam të qëndronim lider në treg me numrin më të lartë të kartave të debitit në Shqipëri. Në 2011 numri i kartave të debitit u rrit me 6,5%. Numri i veprimeve të kryera me këto karta në ATM dhe POS është rritur gjithashtu.

Transferrat

Numri i pagesave dhe i transfertave për klientët individë dhe mikro u rrit ndjeshëm me 29% gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010, ndërkohë që të ardhurat nga komisionet e transfertave dhe pagesave janë rritur me 3%. Gjatë 2011 komisionet për pagesat kombëtare u ulën ndjeshëm në bazë të direktivave të reja të enteve rregullatore, me qëllim promovimin e pagesave nëpërmjet sistemit bankar.

Divizioni i Zhvillimit të Rrjetit

Rrjeti i Degëve

Gjatë vitit 2011 ne jemi përqëndruar kryesisht në përmirësimin e përvojës së klientit në degët tona. Ne kemi kryer ndryshime në linjën tonë të parë në mënyrë që punonjësit tanë të jenë plotësisht të gjithanshëm përsa u përket aftësive të tyre për t'u shërbyer klientëve në një ndërveprim të vetëm. Bankierët tanë janë tashmë në gjendje që të trajtojnë transaksionet jo-kesh të klientit dhe gjithashtu ti ndihmojnë ata për nevojat e tyre të tjera financiare më komplekse. Për të mbështetur këto përpjekje, u prezantua një mjet i ri i quajtur "Profili Financiar" për të vlerësuar më mirë nevojat e klientëve tanë dhe për të propozuar zgjidhje të përshtatura mirë me situatën e tyre të veçantë. Një kohë e rëndësishme është investuar për trajnimin e personelit të degëve tona në drejtimin si të aftësive teknike, ashtu dhe të shitjeve. Qëndrimi ynë për të patur konsumatorin në epiqendër ka provuar se ka qenë i suksesshëm siç konfirmohet edhe nga indeksi i cilësisë së shërbimit tonë, i cili është përmirësuar vazhdimisht gjatë të gjithë vitit 2011.

Në frontin e zhvillimit të biznesit, rrjeti i degëve ishte me të vërtetë aktiv në kreditimin personal në vitin 2011, siç dëshmohet nga fushatat tona të shpeshta të kredidhënies dhe rritja e rezultateve në tregun e aksioneve. Njëkohësisht, ne kemi qenë në gjendje për të arritur rritje në fusha të tjera kyçe, duke përfshirë depozitat dhe bazën e klientit. Ne kemi gjithashtu kënaqësinë që të konfirmojmë se në vitin 2012, degët tona do të shërbejnë si qendra të shpërndarjes për Fondin e ri të Investimeve të quajtur "Raiffeisen Prestigj".

Përkrahja e bizneseve Mikro mbeti një prioritet kyç në degët tona, gjë që dëshmohet nga rritja e fuqishme që bëhet e ditur në seksionin e "Segmentit" të këtij raporti. Ne vazhduam të investojmë për zhvillimin e burimeve tona njerëzore të përkushtuara për të shërbyer në këtë segment të rëndësishëm të klientit.

Përveç kësaj, ne kemi rritur ndjeshëm veprimtarinë e shitjeve të drejtpërdrejta me partnerët tanë të jashtëm. Ne kemi rritur numrin e partnerëve individë dhe kemi zgjeruar biznesin tonë me ato ekzistuese. Rezultati ishte një rritje 30% në aktivitetet e Financimit të klientëve Individë. Ne ishim gjithashtu të suksesshëm në lançimin e forcës së "Shitjeve Direkte" nga celulari, i përbërë nga 17 punonjës, kryesisht aktivë në zonën e Tiranës. Ata mbeten të përkushtuar për të kompletuar rrjetin tonë të degëve duke identifikuar, kualifikuar dhe para-shitur klientët ekzistues dhe klientëve potencial në zonat e produkteve dhe shërbimeve kryesore të klientëve Individë. Së fundi, ne kemi forcuar marrëdhëniet me ndërtuesit në mënyrë që t'u japim klientëve tanë të përbashkët financime hipotekare.

Rrjeti i terminaleve POS

Në vitin 2011 Raiffeisen Bank vijoi me zhvillimin e rrjetit të saj të terminaleve POS në mbarë vendin duke e bërë kështu rrjetin më të gjerë në tregun bankar. Ky shërbim u ofron klienteve tanë mundësinë e përdorimit të kartave të debitit dhe

kreditit të markave VISA, Visa Electron, MasterCard dhe Maestro për blerje në pikat e shitjeve si edhe tërheqje cash pranë degëve të bankës. Deri në fund të vitit 2011 rrjeti POS arriti në një total prej 1300 terminalësh, 24 prej të cilëve në degë të bankës (shërbimi Cash Advance i cili ofron mundësinë e tërheqjes së parave me anë të POS). Rrjeti i terminalëve POS u shtri në rreth 35 qytete të vendit duke ua ofruar këtë shërbim mbi 65 kategorive të ndryshme biznesesh duke përfshirë hotele, agjenci udhëtimi, dyqane, restorante, pika karburanti, markete si edhe qendrat tregtare më të mëdha dhe më të reja në vend. Gjatë 2011 Banka rriti performancën e këtij rrjeti në terma transaksionesh dhe volumesh, kjo falë fokusimit në nevojat dhe kërkesat e tregtarëve si edhe duke ndjekur në kohë zhvillimet më të fundit teknologjike të këtij shërbimi elektronik për të ofruar veprime sa më të shpejta dhe sigurta.

Rrjeti ATM

Gjatë vitit 2011 Raiffeisen Bank mbajti përsëri pozicionin lider në tregun bankar shqiptar me një total prej 193 ATM, një diferencë e konsiderueshme me bankat e tjera në vend. Llojet e kartave të pranuar në rrjetin ATM janë VISA, VISA Electron, PLUS, MasterCard, Maestro dhe Cirrus, pa kufizime për ndonjë vend apo bankë lëshuese. Në 2011 tërheqjet në monedhën EURO u ofruan në 28 ATM në mbarë vendin, me një fokus të veçantë në zonat turistike, qendrat tregtare dhe zonat më të populluara. Rrjeti ATM i Raiffeisen Bank vazhdon të mbetet rrjeti i vetëm në treg i certifikuar plotësisht për teknologjinë e leximit të kartave me Chip për markat Visa dhe MasterCard duke i dhënë Bankës një avantazh të konsiderueshëm dhe duke u ofruar kartëmbajtësve nivelet më të larta të sigurisë së transaksioneve. Gjatë 2011 Banka shtoi gamën e shërbimeve të ofruara në rrjetin ATM duke ofruar shërbimin më të ri të ndryshimit të PIN-it. Ky shërbim bën të mundur ndryshimin e PIN-it të kartave të debitit dhe të kreditit të lëshuara nga Raiffeisen Bank dhe ofrohet pa komision. Gjithashtu në mbarë rrjetin ATM u plotësua instalimi i kamerave duke i ofruar kartëmbajtësve tanë dhe atyre të çdo banke tjetër që përdorin ATM-të tona një siguri më të lartë gjatë kryerjes së veprimeve me karta.

E-Banking

Në rolin e Bankës lider në Shqipëri, Raiffeisen Bank i është dedikuar transformimit të vazhdueshëm të tregut, duke patur qëllim ta bëjë më të lehtë për klientët aksesin dhe përdorimin e shërbimeve bankare.

Duke filluar në Nëntor 2011, Raiffeisen Bank lançon bankingun nëpërmjet celularit si një kanal të sigurtë alternativ i cili i shtohet shërbimeve elektronike bankare për individë dhe biznese. Mobile Banking është shërbimi më i plotë dhe gjithëpërfshirës, pjesë e kanaleve ekzistuese elektronike bankare, duke i lejuar klientëve të bankës të kryejnë shumë aktivitete financiare bankare thjesht duke përdorur telefonin celular në çdo kohë dhe në çdo vend. Bankingu nëpërmjet celularit i jep mundësinë dhe fleksibilitetin klientëve për të kontrolluar llogaritë, kartat, kreditë, depozitat e tyre ose të kryejnë pagesa utilitare dhe transaksione bankare vetëm nëpërmjet telefonit celular.

Interesi në bankingun nëpërmjet celularit është i madh dhe po fuqizohet akoma, kështu që duke ju përgjigjur mundësive që ofrohen nga zhvillimi i teknologjisë, Raiffeisen Bank së bashku me partnerët e saj do të vazhdojë të udhëheqë zhvillimin e shërbimeve të reja dhe bankingut retail.

Në Prill 2011, platforma e Internet Banking u përmirësua me sukses me një modul të ri pagesash i dedikuar vetëm për taksat. Bankingu nëpërmjet internetit ofron 24/7 informacion për balancat dhe transaksionet e llogarive, transferimin e fondeve drejt bankave kombëtare dhe ndërkombëtare, pagesën e kartës së kreditit, pagesën e faturave të kompanive utilitare. Duke përdorur thjesht një mesazh SMS nga celulari i tyre, klientët mund të marrin informacion automatik dhe me kërkesë mbi gjendjen e llogarisë dhe transaksioneve të fundit duke marrë dhe dërguar mesazhe njoftuese SMS.

Call Center

E krijuar në vitin 2005 si një ekip i vogël prej 5 punonjësish, sot Call Center 24/7 i Bankës Raiffeisen është pika kryesore e kontaktit për një pjesë të mirë të klientëve. Call Center është i përbërë nga 18 punonjës shumë të motivuar, me një eksperiencë pune në fushën e shërbimit ndaj klientëve nga 2 deri në 6 vjet. Detyrat e tyre janë të përqëndruara në tre fusha të rëndësishme të shërbimit ndaj klientëve.

- Njësia inbound siguron informacion sipas kërkesave të klientëve, për produktet ose shërbimet e bankës, si dhe ju ofron asistencë klientëve për çështje lidhur me produktet e kartave, internet dhe mobile banking.
- Njësia outbound zhvillon çdo vit fushata telemarketingu të cilat kanë synim promovimin e produkteve dhe shërbimeve të Bankës, duke bërë oferta të dedikuara që janë pjesë e programit të Manaxhimit të Marrëdhënive me klientët e bankës (CRM).
- Njësia e Manaxhimit të Ankesave është përgjegjëse për shqyrtimin dhe zgjidhjen e të gjitha ankesave të klientëve të depozituara nëpërmjet kanaleve të ndryshme – degë, e-mail, etj.

Pikat Kryesore të 2011

- 97 % e telefonatave të ofruara në Call Center kanë marrë përgjigje që në tentativën e tyre të parë
- Janë investiguar 1,689 raste ankesash
- Janë zhvilluar 137 fushata telemarketingu

- Rreth 1,7 milion mesazhe SMS janë dërguar drejt klientëve kryesisht me qëllim informimi për kreditime në llogari, rinovime të produkteve të ndryshme si dhe me qëllim promovim për oferta të dedikuara kryesisht për produktet e kredive.

Punonjësit e Call Center do të vazhdojnë të gjitha përpjekjet e tyre për mbajtjen e statusit si Qendra me e mirë për shërbimin ndaj klientëve për Shërbimin ndaj Klientëve.

Kanalet e Shpërndarjes

Viti 2011 ishte një vit i konsolidimit dhe përmirësimit të rrjetit tonë të degëve pas zbatimit të ndryshimeve të rëndësishme në strukturën e menaxhimit gjatë vitit të kaluar. Ne ruajmë pozicionin tonë të liderit, si banka më e madhe e Shqipërisë me 103 degë në shërbim të gjithë territorit të vendit tonë. Ne konsoliduam dhe modernizuam rrjetin tonë të degëve me zhvendosjen ose zgjerimin e 4 degëve dhe hapjen e 3 degëve të reja, duke përfshirë edhe degën tonë në Tirana East Gate, e cila ofron orar të zgjatur për 7 ditë në javë. Gjatë vitit të kaluar, ne kemi përfunduar modernizimin e fasadave të jashtme të të gjitha degëve tona. Në vitin 2012, ne do të vazhdojmë të punojmë në drejtim të përmirësimit të mjedisit të shërbimit të degëve tona në interes të klientelës sonë të gjerë. Në dy prej degëve tona kryesore në Tiranë janë kryer tashmë rinovime të gjithanëshme, gjë që konfirmon përkushtimin tonë në mënyrë që klientët tanë të ndjehen rehat në mjediset tona.

Gjatë vitit 2011 ne jemi përqëndruar kryesisht në përmirësimin e përvojës së klientit në degët tona. Ne kemi kryer ndryshime në linjën tonë të parë në mënyrë që punonjësit tanë të jenë plotësisht të gjithanshëm përsa u përket aftësive të tyre për t'u shërbyer klientëve në një ndërveprim të vetëm. Bankierët tanë janë tashmë në gjendje të trajtojnë transaksionet jo-kesh të klientit dhe gjithashtu ti ndihmojnë ata për nevojat e tyre të tjera financiare më komplekse. Për të mbështetur këto përpjekje, u prezantua një mjet i ri i quajtur "Profili Financiar" për të vlerësuar më mirë nevojat e klientëve tanë dhe për të propozuar zgjidhje të përshtatura mirë me situatën e tyre të veçantë. Një kohë e rëndësishme është investuar për trajnimin e personelit të degëve tona në drejtim si të aftësive teknike, ashtu dhe të shitjeve. Qëndrimi ynë për të patur konsumatorin në epiqendër ka provuar se ka qenë i suksesshëm siç konfirmohet edhe nga indeksi i cilësisë së shërbimit tonë, i cili është përmirësuar vazhdimisht gjatë gjithë vitit 2011.

Në frontin e zhvillimit të biznesit, rrjeti i degëve ishte me të vërtetë aktiv në kreditimin personal në vitin 2011, siç dëshmohet nga fushatat tona të shpeshta të kredidhënies dhe rritja e rezultateve në tregun e aksioneve. Njëkohësisht, ne kemi qenë në gjendje për të arritur rritje në fusha të tjera kyçe, duke përfshirë depozitat dhe bazën e klientit. Ne kemi gjithashtu kënaqësinë që të konfirmojmë se në vitin 2012, degët tona do të shërbejnë si qendra të shpërndarjes për Fondin e ri të Investimeve të quajtur "Raiffeisen Prestigij".

Përkrahja e bizneseve Mikro mbeti një prioritet kyç në degët tona, gjë që dëshmohet nga rritja e fuqishme që bëhet e ditur në seksionin e "segmenteve" të këtij raporti. Ne vazhduam të investojmë për zhvillimin e burimeve tona njerëzore të përkushtuara për të shërbyer në këtë segment të rëndësishëm të klientit.

Përveç kësaj, ne kemi rritur ndjeshëm veprimtarinë e shitjeve të drejtpërdrejta me partnerët tanë të jashtëm. Ne kemi rritur numrin e partnerëve individë dhe kemi zgjeruar biznesin tonë me ato ekzistuese. Rezultati ishte një rritje 30% në aktivitetet e Financimit të klientëve individë. Ne ishim gjithashtu të suksesshëm në lançimin e forcës së "Shitjeve Direkte" nga celulari, i përbërë nga 17 punonjës, kryesisht aktivë në zonën e Tiranës. Ata mbeten të përkushtuar për të kompletuar rrjetin tonë të degëve duke identifikuar, kualifikuar dhe para-shitur klientët ekzistues dhe ata potencial në zonat e produkteve dhe shërbimeve kryesore të klientëve individë. Së fundmi, ne kemi forcuar marrëdhëniet me ndërtuesit në mënyrë që t'u japim klientëve tanë të përbashkët financime hipotekare.





Në kuadrin e promovimit të sistemit arsimor, në Berat u zhvillua një nga aktivitetet më interesante të vitit; Galeria e artit 'Edward Lear', e mbështetur nga Raiffeisen Bank.

Thesari dhe bankingu i Investimeve

Të ardhurat fikse

Edhe gjatë vitit 2011 vazhduam të ishim investuesit kryesor në tregun e letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë. Pjesëmarrja jonë në tregun primar të bonove të thesarit është ulur paksa si rrjedhojë e fokusimit tonë në letra me vlerë më afatgjata ku investimet tona në obligacione thesari zunë rreth 58 përqind të tregut të obligacioneve në vend.

Përgjatë gjithë vitit kemi pasur një portofol të mirëstrukturuar, i cili është i përbërë nga portofoli i investimeve me letra me vlerë të mbajtura deri në maturim dhe nga portofoli i tregtueshëm; ky i fundit ka qenë relativisht i qëndrueshëm gjatë 2011 dhe në fund të muajit Dhjetor kapi shifrën prej 281 milionë Euro. Investimet tona afatgjata në obligacione thesari ishin 77.80 përqind e portofolit tonë të letrave me vlerë.

Viti 2011 ishte një vit i suksesshëm për njësinë e të ardhurave fikse, njësi kjo e cila ka qenë shumë aktive me bankat dhe institucionet financiare në tregun sekondar dhe ka manaxhuar më së miri portofolin e saj si dhe investimet e reja. Qëllimi ynë ka qenë që të ofrojmë mundësi dhe alternativa investimesh si për klientët individë, ashtu edhe për ata korporatë, prandaj mund të themi që jemi krenarë sepse jemi kontribuesit kryesorë në tregun sekondar të bonove dhe obligacioneve të thesarit, duke i tregtuar ato në degët tona në të gjithë vendin.

Raiffeisen Bank ka dhënë gjithmonë kontributin dhe mbështetjen e saj duke përditësuar informacionin për ecurinë e yield-eve të bonove të thesarit në të gjitha degët e saj, në mënyrë që t'i japë klientëve një informacion sa më të qartë duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në treg primar dhe sekondar.

Banka jonë vijoi të kryente edhe aktivitetin e kujdestarit të letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë duke mundësuar investitorët e huaj dhe ata vendas të marrin pjesë në tregun tonë të letrave me vlerë. Ky shërbim si edhe të tjerë që do të ofrojmë në një të ardhme të afërme, janë pjesë e përpjekjeve dhe qëllimeve tona për të qenë pjesë e zhvillimit të tregut vendas. Si gjithmonë Raiffeisen Bank është një sipërmarrëse e transaksioneve të ndryshme financiare që janë hedhur në treg për të kontribuar më tej në zhvillimin e tregut vendas. Në këtë kontekst duam të theksojmë që kemi mbyllur transaksione REPO me bankat e nivelit të dytë duke alternuar në këtë mënyrë instrumentat e ndryshme dhe duke përmirësuar pozicionin tonë.

Mund të themi që mbyllëm një 2011 të suksesshëm, dhe jemi gati të përballojmë sfidat dhe mundësitë që do të na ofrojë 2012.

Tregu i parasë

Viti 2011 ka qenë një vit shumë i suksesshëm për njësinë e Tregut të Parasë. Volumet gjatë këtij viti arritën nivelin më të lartë, çfarë rritën ndjeshëm investimet ndërbankare në tregun vendas dhe atë të huaj duke e zhvilluar më tej aktivitetin e kësaj njësie.

Përmirësimi i kuotimeve në favor të klientëve për secilin nga segmentet ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e transaksioneve si dhe volumeve për tregun e parasë.

Për një administrim më të mirë të likuiditetit afatshkurtër të bankës njësia e tregut të parasë ka përdorur instrumenta të ndryshëm financiarë për të përmbushur në kohë të gjitha detyrimet e planifikuara dhe të paplanifikuara ndaj klientëve. Kjo njësi luan një rol kyç në menaxhimin afatshkurtër të likuiditetit të bankës nëpërmjet një bashkpunimi të ngushtë me departamentet e tjera si dhe duke ju përmbajtur standarteve dhe rregulloreve në fuqi.

Njësia e tregut të parasë është përpjekur gjithmonë që të maksimizojë kthimin nga investimi i portofolit të saj, duke ju përmbajtur limiteve të aprovuara dhe duke marrë parasysh uljen e ndjeshme të tyre gjatë krizës ekonomike në mbarë botën gjatë këtij viti.

Raiffeisen Bank është një nga kontribuesit kryesorë në tregun monetar vendas dhe luan rolin e liderit për vendosjen e çmimit në treg duke qenë një nga kontribuesit kryesorë në panelin e Bankës së Shqipërisë për TRIBID/TRIBOR.

Këmbimi valutor

Edhe ky vit është karakterizuar nga një luhatshmëri e lartë e kurseve të këmbimit në tregun ndërkombëtar. Situata e krizës ekonomike në disa vende Europiane dhe në veçanti Greqinë u reflektua edhe në tregun shqiptar. Monedha europiane u kuotua në fillim të Qershorit përkundrejt monedhës vendase në nivelet historike më të larta; 142.84. Njësia e Këmbimeve Valutore dha mbeshtetjen e saj maksimale në këtë treg të trazuar duke mbajtur një spread të vogël në blerje/ shitje si dhe duke kuotuar me çmime shumë konkurruese në tregun ndërbankar dhe me klientët.

Ky vit ishte shumë i sukseshëm për Njësinë e Këmbimeve Valutore e cila duke analizuar me kujdes situatat e ndryshme që ndikuan në tregjet financiare arriti të menaxhonte me kujdes pozicionet valutore të bankës duke e mbyllur vitin me rezultate të larta.

Volumet e transaksioneve të këmbimeve valutore janë rritur në krahasim me 2010 duke arritur shumë më 220 milion Euro për muaj ku pjesën më të madhe e zënë veprimet Eur/Usd, ndërkohë veprimet në tregun ndërbankar lokal dhe atë të huaj ishin më tepër se 200 milion në muaj.

Shitjet e thesarit

Njësia e shitjeve të Thesarit edhe gjatë vitit 2011, arriti të ruante pozicionin e saj në treg, duke u shërbyer në çdo moment klientëve të RBAL.

Falë kushteve preferenciale të ofruara për të gjitha segmentet e biznesit, kjo njësi luajti një rol kyç në gjetjen e mundësive dhe dhënien e zgjidhjeve për klientët në lidhje me produktet FX dhe normave të interesit. Përveç rritjes së fitimit dhe të qënurit pranë nevojave të klientit, një objektiv themelor ishte edhe forcimi akoma më shumë i marrëdhënive me klientit, një faktor shumë i rëndësishëm gjatë krizave financiare.

Edhe pse në një vit të vështirë përsa i takon situatës ndërkombëtare financiare, njësia e shitjeve pranë departamentit të Thesarit arriti që të realizonte objektivat e saj, duke u mbështetur në marrëdhënien e fortë mes dealing room dhe njësitë e tjera të biznesit të bankës.





Në Tiranë zhvillohen shumë nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore të vitit, të cilat kanë patur mbështetjen e plotë të Raiffesien Bank. Vlen të përmenden, "Tre tenorët", opera "Werther", "Turandot" Balloja e fundvitit në Pallatin e Operas dhe Baletit, etj.

Përgjegjësi Sociale

Raiffeisen Bank në Shqipëri përveç ofrimit të shërbimeve dhe produkteve bankare është e përkushtuar të kontribuojë edhe në përkrahjen e projekteve të ndryshme të komunitetit, si pjesë e përgjegjësisë së saj sociale. Kështu, Raiffeisen Bank ka sponsorizuar dhe ka ofruar donacione për projekte të ndryshme në fushën e arsimit, mirëqenies sociale, shëndetësisë e mjedisit.

Raiffeisen Bank u nderua me Çmimin e Filantropisë për kontributin në nivel lokal me motivacionin: Për kontributin e dhënë në mbështetje të zhvillimit të arsimit dhe kulturës në qytetin e Shkodrës, nëpërmjet rikonstruksionit të sallës së koncerteve në shkollën e mesme artistike “Prenkë Jakova”, mbështetjes në infrastrukturë për Fakultetin Ekonomik, Universiteti “Luigj Gurakuqi” si dhe aktiviteteve të tjera sociale – edukuese. Raiffeisen Bank u përzgjedh nga konkursi i organizuar nga Partnerët Shqipëri me bizneset që kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit.

Dhe kjo pasqyron vetëm një pjesë shumë të vogël të kontributit që ka dhënë Raiffeisen Bank gjatë gjithë vitit dhe në të gjithë territorin e vendit.

Në kuadër të përgjegjësisë sociale, Raiffeisen Bank Shqipëri ka mbështetur këtë vit kampet verore të organizuar nga Terre des Hommes në Shqipëri dhe konkretisht në Korçë, Durrës, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë. Suksesi kampeve verore këtë vit qëndronte jo vetëm në rritjen e numrit të fëmijëve që morrën pjesë, por edhe në faktin që shumica e këtyre fëmijëve vinin nga familje të rrezikuara dhe të marginalizuara nga të gjitha rajonet. Kampet e mundësuar nga Raiffeisen Bank krijuan një mjedis të sigurt dhe të edukuar, ku fëmijët mundën të argëtohen dhe të luajnë si dhe një atmosferë ku fëmijët të zhvillonin aftësitë sociale dhe emocionale.

Gjithashtu Raiffeisen Bank është angazhuar edhe në projekte të tjera sociale si dhurimi i librave për shtëpinë e fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë, kampi veror për fëmijët me aftësi të kufizuara të shkollës speciale në Elbasan, etj.

Përveç projekteve me karakter social, të shumta kanë qenë edhe aktivitetet me karakter kulturor të cilat kanë pasur mbështetjen e Raiffeisen Bank. Këto aktivitete kanë pasur si qëllim argëtimin dhe edukimin e qindra mijëra fëmijëve që kanë qenë të përfshirë në to, kanë gjallëruar dhe përmirësuar ndjeshëm jetën e tyre dhe të komunitetit në tërësi.

Në vijim të politikës së saj të sponsorizimeve të fokusuar kryesisht në sektorin e arsimit, Raiffeisen Bank ka dhënë kontributin e saj në një sërë projektesh në këtë fushë për shumë shkolla 8-vjeçare dhe të mesme në qytete të ndryshme në vend. Projekte të cilat kishin në fokus rikonstruksionin e bibliotekave, pajisjen e tyre me libra, aktivitete të ndryshme edukative e shoqërore. Ky kontribut është bërë i mundur edhe në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet Raiffeisen Bank dhe Bashkive e Drejtorive Arsimore Rajonale në këto qytete.

Po në këtë kuadër, Raiffeisen Bank ka vijuar bashkëpunimin e saj edhe këtë vit me Fakultetin Ekonomik me mbështetjen e “Lojës në Bursë” me studentët e Financës së këtij fakulteti, si dhe ka dhuruar 2 laboratorë kompjuterash për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Një fokus i veçantë këtë vit i është dhënë edhe sektorit të shëndetësisë, si një nga sektorët më të ndjeshëm dhe të rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së komunitetit. Në këtë kuadër, Raiffeisen Bank ka dhuruar pajisje mjekësore për spitalin e Lezhës, Korçës e Gjirokastrës, Laçit, Kuçovës dhe Durrësit.

Raiffeisen Bank ka kontribuar në përmirësimin e jetës së komunitetit edhe nëpërmjet mbështetjes së projekteve mjedisore. Në këtë kuadër ka financuar për të tretin vit në rradhë projektin për pastrimin e bregdetit të ndërmarrë dhe organizuar nga shoqata “Forumi i Mendimit të Lirë”. Kështu me kontributin e Raiffeisen Bank është bërë i mundur pastrimi i bregdetit të Gjirit të Lalzit, Zvërnecit, etj., ku kontribuoi vullnetarisht edhe stafi i Raiffeisen Bank. Gjithashtu, kontributi është zgjeruar më tej në këtë fushë me shtimin e sipërfaqeve të gjelbëruara nëpërmjet ngritjes së parqeve të gjelbëruara në Gjirokastrë, Sarandë, etj.



Kultura është një nga fushat më të rëndësishme dhe që ka qenë në fokusin e Raiffeisen Bank në të gjithë Shqipërinë, si përshembull Festivali i Filmit Ballkanik dhe i Artit të gatimit.

Burimet Njerëzore dhe Trajnimet

Përmes Politikave & Programeve të Burimeve Njerëzore, ne fokusohemi në motivimin e stafit, kënaqësinë e tij, dhe ofrimin/krijimin e një mjedisi pune premtues dhe një pakete financiare konkurruese, si edhe programe trajnimi efektive.

Statistika

Shifrat e arritura për vitin 2011:

- Numri total i punonjësve: **1.471**
- Punonjëse femra: **73.6%**
- Punonjës meshkuj: **26.4%**
- Moshë mesatare: **33.6**
- numri i përgjithshëm i ditëve të trajnimit: **4.420**
- mbi **1.200** punonjës kanë ndjekur të paktën një trajnim
- Numri i ditëve të trajnimit për punonjës është: **3.25**
- Buxheti i përgjithshëm i shpenzuar për aktivitetet e trajnimit & zhvillimit është: **337.217 Euro**

Trajnimi & Zhvillimi

Trajnimi dhe zhvillimi përbën një mjet strategjik që ndihmon në arritjen e synimeve dhe objektivave të biznesit të organizatës.

Trajnimi dhe zhvillimi është procesi i përfitimit ose transferimit të KSA-ve (njohurive, aftësive dhe kualifikimeve) të domosdoshme për të performuar një aktivitet apo detyrë të caktuar; si pasojë përfitimet për punonjës in edhe për punëdhënësin nga trajnimi dhe zhvillimi janë të natyrës strategjike, pra të një natyre shumë të gjërë.

Trajnimi dhe zhvillimi ndërmerr një sërë hapash mësimore për të përmbushur sfidat aktuale dhe të ardhshme të biznesit, që variojnë nga trajnimi i punonjësve për kryerjen e detyrave aktuale dhe në shkëmbimin e njohurive për të përmirësuar horizontin e biznesit dhe shërbimin ndaj klientëve.

Aktivitetet kryesore të trajnimit dhe zhvillimit u fokusuan në:

Trajnimi Orientues për Punonjësit e Rinj

Punonjësit e rinj kanë ndjekur Paketën Orientuese të Trajnimit, e cila është shumë e rëndësishme, sepse ata prezantohen me misionin e bankës, vlerat e korporatës, objektivat dhe politikat e saj. Gjatë kësaj faze trajnimi, punonjësit përfitojnë informacion të përgjithshëm mbi një sërë produktesh, shërbimesh dhe politikash të bankës. Paketa trajnimi të dedikuara janë përgatitur për segmente të caktuara të biznesit.

Përmiresimi i Cilësië së Shërbimit dhe Aftësive Shitëse

Është e rëndësishme të kesh një marrëdhënie afatgjatë me klientin në mënyrë që të jesh konkurrues në treg dhe të kesh sukses. Punonjësit e trajnuar në mënyrën e duhur sigurojnë që klientët të ndihen mirë në ruajtjen e marrëdhënies këshnieve të tyre me kompaninë.

Gjatë vitit 2011, banka ka investuar në ofrimin e trajnimeve dhe seminareve për të rifreskuar njohuritë mbi produktet dhe procedurat e stafit të front office. Janë organizuar disa trajnime për aftësitë komunikuese për të rritur cilësinë e shërbimit të klientit, si dhe aftësitë shitëse, negociuese dhe coaching.

Trajnimet për Menaxheret

Trajnimi i aftësive drejtuese të menaxherëve tanë është çelësi në dhënien e rezultateve konkrete për një organizatë.

Sektori i Trajnimit dhe Zhvillimit kordinon ofertat mësimore me objektivat strategjike të bankës për të siguruar që iniciativat trajnuese dhe edukative të mbështetin objektivat e kompanisë.

Në vitin 2011, janë organizuar disa programe trajnimi specifike për menaxhimin dhe aftësitë drejtuese për drejtorët në drejtori dhe degë.

Kurset e e-learning

Banka ka prezantuar platformën e-Learning për të gjithë punonjësit e saj. Kjo platformë është një metodë e re trajnimi që ndiqet nëpërmjet kompjuterit.

Skuadra RBAL e E-learning ka zhvilluar 3 kurse mësimi me temat e mëposhtme:

4. Manuali i Përputhshmërisë
5. Politika kundër Pastrimit të Parave
6. Shërbimet e Mobile Banking

Kjo metodë është shumë e rëndësishme në arritjen lehtësisht të audiencave të mëdha të trajnimit në çdo kohë.

Praktika shkollore

Banka jonë vazhdon të mbetet një nga kompanitë më tërheqëse për praktikantët, të cilët e kryejnë atë në përfundim të studimeve të tyre. Ky program është përdorur me sukses për të përzgjedhur dhe punësuar talentet e reja, më të mirë dhe më të motivuar nga universitete të ndryshme.

Ne kemi ruajtur një standart të lartë në përzgjedhjen e studentëve, duke afruar studentët më të mirë nga universitetet private dhe publike.

Në këtë kuadër, iniciativë e rëndësishme është përfshirja e RBAL në programin FASTIP, duke mbështetur gjithsej 8 studentë, të cilët po ndjekin studimet e tyre në degën "Menaxhim Bankar" dhe të cilët do të punësohen pas diplomimit të tyre, duke na përgatitur për konkurrencën dhe sfidat e reja në tregun e punës në të ardhmen.

Menaxhimi i Performancës

Politikat e Burimeve Njerëzore të RBAL synojnë të përforcojnë një kulturë që mbështet performancën e lartë të punonjësve tanë. Ne gjithashtu synojmë të nxisim dhe përforcojmë kompetencat/sjelljet e dëshiruara dhe t'i motivojmë njerëzit tanë përmes një sistemi të konsoliduar të menaxhimit të performancës. Sistemi i Menaxhimit që po përdoret nga RBAL merr në konsideratë arritjen e objektivave/ synimeve nga ana e punonjësit dhe kompetencat që shfaqen në arritjen e rezultateve.

Vlerësimi i performancës

Gjatë vitit 2011, kemi vendosur një skemë incentive mujore për stafin e degës dhe segmente të tjera të bankës si dhe një skemë bonusi vjetor për stafin e Drejtorisë për të rritur motivimin dhe përfshirjen e punonjësve tanë.

Duke zbatuar programin "Shpërblim dhe Mirënjohje" gjatë vitit 2011, ne kemi kontribuar në rritjen e përfshirjes dhe motivimit të stafit, duke shpërblyer dhe nxjerrë në pah performuesit më të mirë, në mënyrë që të formojmë një kulturë organizative nxitëse.





Sponsorizimet më të rëndësishme të bëra në Korçë të mbështetura nga Raiffeisen Bank, mbulojnë fushën e shëndetësisë, sistemin arsimor dhe komunitetin.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Raporti i auditorit të pavarur dhe
Pasqyrat financiare të konsoliduara
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011

Pasqyra përmbledhëse

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Pasqyrat financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar	149
Pasqyra e konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave	150
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital	151
Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë	152
Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara	153 - 191

Raporti i Auditorit të Pavarur

Aksionarëve të Raiffeisen Bank sh.a.

Raporti mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Raiffeisen Bank sh.a. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2011 dhe pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Raiffeisen Bank sh.a. më 31 dhjetor 2011 si dhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte.

Deloitte Albania sll

4 korrik 2012


Tiranë, Shqipëri

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2011


(të gjitha shumat janë në mijë Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Aktivët			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7	24,076,796	19,253,928
Shuma të kushtëzuara	8	25,671,451	23,297,417
Investime të mbajtura për tregtim	9.1	39,202,048	38,668,174
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	105,760,202	95,361,970
Hua dhe paradhënie për klientët	10	124,126,282	98,398,431
Aktive afatgjata materiale	11	1,808,116	1,565,787
Aktive afatgjata jomateriale	11	609,060	296,588
Investime në kapital	12	25,713	17,237
Emri i mirë	13	92,783	92,783
Aktive të tjera	14	1,481,846	1,031,336
Totali i aktiveve		322,854,297	277,983,651
Detyrimet			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	15	5,335,409	3,885,069
Marrëveshje të anasjallta të riblerjes	16	8,150,088	8,311,578
Detyrime ndaj klientëve	17	278,515,611	236,595,234
Tatimi për t'u paguar		10,258	81,296
Tatimi i shtyrë pasiv	18	125,375	134,597
Detyrime të tjera	19	1,238,209	1,322,235
Totali i detyrimeve		293,374,950	250,330,009
Kapitali			
Kapitali aksionar	20	9,926,093	9,926,093
Rezerva e përgjithshme	21	6,314,300	2,801,000
Rezervat e filialit	22	63,773	-
Rezerva e rivlerësimit		25,713	17,237
Fitimi i pashpërndarë		13,064,551	14,840,357
Totali i kapitalit që i përket aksionarëve të Bankës		29,394,430	27,584,687
Interesat jo kontrolluese	23	84,917	68,955
Totali i kapitalit aksionar		29,479,347	27,653,642
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		322,854,297	277,983,651

Këto pasqyra financiare të konsoliduara u miratuan nga Këshilli Mbikqyrës më 8 mars 2012 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai
Zv. Drejtor i Bordit Drejtues

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011
(të gjitha shumat janë në mijë Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Të ardhura nga interes	24	19,975,992	19,086,520
Shpenzime për interesa	25	(7,673,450)	(7,105,850)
Të ardhura neto nga interesat		12,302,542	11,980,670
Të ardhura nga komisionet	26	1,405,700	1,385,638
Shpenzime për komisionet	27	(307,220)	(277,499)
Të ardhura neto nga komisionet		1,098,480	1,108,139
Të ardhura neto nga tregtimi	28	1,980,684	2,092,358
Të ardhura të tjera operative, neto	29	(101,834)	4,012
		1,878,850	2,096,370
Primi i sigurimit të depozitave	30	(722,809)	(690,046)
Shpenzime për personelin	31	(2,219,571)	(2,040,820)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11	(560,938)	(538,024)
Shpenzime të përgjithshme administrative	32	(1,911,283)	(1,577,777)
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	10,19	(2,008,781)	(4,283,461)
		(7,423,382)	(9,130,128)
Fitimi para tatimit		7,856,490	6,055,051
Tatimi mbi fitimin	33	(771,208)	(694,072)
Fitimi neto për vitin		7,085,282	5,360,979
Të ardhura të tjera përmbledhëse			
Rezerva e vlerës së drejtë (aktive financiare të disponueshme për shitje)			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë	11	8,476	(2,497)
Total i të ardhurave përmbledhëse		7,093,758	5,358,482
I përket:			
Aksionarëve të Bankës		7,069,320	5,344,032
Interesave jo kontrolluese		15,962	16,947

Pasqyra e konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011
(të gjitha shumat janë në mijë Lek)

	I përket aksionarëve të Bankës						
	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva e rivlerësimit	Rezervat e filialit	Fitimi i pashpërndarë	Interesat jo kontrolluese	Totali i kapitalit
Gjendja më 31 dhjetor 2009	4,348,233	2,800,000	19,734	-	17,281,448	24,449,415	52,008 24,501,423
Rritje e kapitalit							
Transferimi i fitimit të pashpërndarë në rezervën e përgjithshme	5,577,860	-	-	-	(5,577,860)	-	-
Dividend i paguar	-	1,000	-	-	(1,000)	-	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse (Shënimi 11)	-	-	-	-	(2,206,263)	(2,206,263)	- (2,206,263)
Fitimi neto për vitin	-	-	-	-	5,344,032	5,344,032	16,947 5,360,979
	-	-	(2,497)	-	-	(2,497)	- (2,497)
Gjendja më 31 dhjetor 2010	9,926,093	2,801,000	17,237	-	14,840,357	27,584,687	68,955 27,653,642
Transferimi i fitimit të pashpërndarë në rezervën e përgjithshme	-	3,513,300	-	-	(3,513,300)	-	-
Dividend i paguar	-	-	-	-	(5,268,053)	(5,268,053)	- (5,268,053)
Rezervat e filialit	-	-	-	63,773	(63,773)	-	-
Fitimi neto për vitin	-	-	-	-	7,069,320	7,069,320	15,962 7,085,282
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	8,476	-	-	8,476	- 8,476
Gjendja më 31 dhjetor 2011	9,926,093	6,314,300	25,713	63,773	13,064,551	29,394,430	84,917 29,479,347

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011
 të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Rrjedhja e parasë nga operacionet		
Fitimi para tatimit	7,856,490	6,055,051
Zëra jo-monetarë në pasqyrën e të ardhurave		
Zhvlërësimi dhe amortizimi	560,938	538,024
Aktivitet afatgjatë materiale të nxjerra jashtë përdorimit	31,841	14,099
Humbje neto nga zhvlërësimi i aktiveve financiare	2,008,781	4,283,461
Të ardhurat neto nga interesi	(12,302,542)	(11,980,670)
Ndryshimi në provigjione për debitorë të tjerë	(11,226)	39,175
	(1,855,718)	(1,050,860)
Rritje në hua dhe paradhënie për institucionet e kreditit	(2,372,510)	(2,951,639)
Rritje në hua dhe paradhënie për klientët	(27,609,464)	(14,343,226)
Rritje në letra me vlerë të tregtueshme	(533,874)	(2,143,983)
(Rritje) / pakësim në aktive të tjera	(450,513)	491,971
Pakësim në REPO të anasjalltë/REPO	(164,355)	(9,553,470)
Rritje në detyrimet ndaj institucioneve financiare	1,447,261	1,685,146
Rritje në detyrimet ndaj klientëve	41,377,537	28,817,051
(Pakësim) / rritje në detyrimet e tjera	(70,083)	401,080
	9,768,281	1,352,071
Interesi i arkëtuar	19,720,869	19,178,026
Interesi i paguar	(7,124,666)	(7,032,976)
Tatimi i paguar mbi fitimin	(854,184)	(527,256)
Paraja neto e gjeneruar në aktivitetet operacionale	21,510,300	12,969,864
Rrjedhja e parasë nga investimet		
Blerje e aktiveve afatgjatë materiale	(1,571,599)	(544,820)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjatë jomateriale	424,019	89,051
Maturimi i letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim	(10,271,799)	(2,274,263)
Rrjedhja e parasë neto e përdorur nga investimet	(11,419,379)	(2,730,033)
Rrjedhja e parasë nga financimet		
Dividend i paguar nga fitimi i pashpërndarë i vitit të kaluar	(5,268,053)	(2,206,263)
Rrjedhja e parasë neto e përdorur në financime	(5,268,053)	(2,206,263)
Rritje neto në para dhe ekuivalentët e saj	4,822,868	8,033,568
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit (shënimi 7)	19,253,928	11,220,360
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (shënimi 7)	24,076,796	19,253,928

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 (të gjitha shumat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. TË PËRGJITHSHME

Raiffeisen Bank sh.a (“Banka”) është emri që Banka mori duke filluar nga data 1 tetor 2004 nga ish Banka e Kursimeve sh.a. Banka e Kursimeve u krijua në vitin 1991 nga ndarja e ish “Instituti të Sigurimeve dhe Arkave të Kursimit” me qëllim administrimin e depozitave të individëve dhe ndërmarrjeve, dhënien dhe administrimin e huave për individët, ndërmarrjet dhe subjektet shtetërore, si dhe për kryerjen e shërbimeve të ndryshme bankare.

Më 11 dhjetor 1992, Banka u regjistrua për të vepruar si Bankë në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr.7560 “Për sistemin Bankar në Shqipëri”. Banka e Shqipërisë i dha Bankës së Kursimeve një licencë të përgjithshme, të patransferueshme dhe të pakufizuar në kohë. Më 27 korrik 1997, në përputhje me Vendimin Nr.17426 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Banka u shndërrua në një Shoqëri me Kapital Aksionar. Aksionari i vetëm i Bankës ishte Ministria e Financës me një kapital fillestar prej 700 milion Lek, i cili përbëhej nga 7,000 aksione me vlerë nominale 100,000 Lek për çdo aksion. Në bazë të këtij vendimi, Banka e Shqipërisë më 11 janar 1999 rinovoi licencën e Bankës për të pasqyruar këto ndryshime.

Më 14 prill 2004, Ministria e Financës së Shqipërisë i shiti Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft (RZB AG) 100% të aksioneve të emetuara dhe në funksionim të Bankës.

Më 21 korrik 2004, RZB AG kaloi 100% të aksioneve në filialin krejtësisht në pronësi të RZB AG, Raiffeisen International AG, Vienna, Austria, i cili është tani aksionari i 100% të aksioneve të emetuara dhe në funksionim të Bankës.

Në Korrik 2010, aksionari i vetëm ndryshoi emrin nga Raiffeisen International Bank-Holding AG, në Raiffeisen Bank International AG. Ky ndryshim u regjistrua në regjistrin tregtar Austriak në tetor 2010.

Më 28 prill 2006 Banka dhe Raiffeisen Leasing International themeluan Raiffeisen Leasing Sh.a. Banka zotëron 75% të aksioneve të shoqërisë. Më 15 janar 2009 Banka mori në pronësi 100% të aksioneve të Instituti Amerikan të Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë, sipas kontratës së shitblerjes së aksioneve të datës 26 dhjetor 2008. Më 23 prill 2009 emri i këtij të fundit ndryshoi në Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.

Më 31 mars 2011, emri i filialit u ndryshua nga “Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.”, në “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a.” dhe më tej, më 30 nëntor 2011, emri u ndryshua në “Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a (më poshtë referuar si “Raiffeisen INVEST”).

Pasqyrat e konsoliduara financiare të Grupit më 31 dhjetor 2011 dhe më 31 dhjetor 2010 përfshijnë Bankën, Raiffeisen Leasing dhe Raiffeisen INVEST (së bashku “Grupi”).

Më 31 dhjetor 2011, Banka operon me një rrjet bankar prej 103 pika shërbimi nëpër të gjithë Shqipërinë (më 31 dhjetor 2010: 103 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 8 distrikte.

Drejtnesit dhe administratorët më 31 dhjetor 2011 dhe 2010:

Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikqyrës)

Heinz Höedl	Kryetar
Herbert Stepic	Anëtar
Peter Lennkh	Anëtar
Martin Grüll	Anëtar
Aris Bogdaneris	Anëtar

Komiteti i Kontrollit

Heinz Höedl	Kryetar
Johannes Kellner	Anëtar
Susana Mitter	Anëtar

Bordi Drejtues

Christian Canacaris	Drejtor i Përgjithshëm
Alexander Zsolnai	Zv. Drejtor i Bordit Drejtues
John McNaughton	Anëtar
Raphaela Bischof-Rothauer	Anëtar

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe interpretimet e tyre të përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (BSNK).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- Instrumentet derivative financiare janë matur me vlerë të drejtë,
- Instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes janë matur me vlerë të drejtë,
- Aktivët financiare të disponueshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Grupit. Përveç rasteve ku tregohet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara jepet në Shënimin 4.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Polikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Polikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga entitetet e Grupit, kështu, nuk janë bërë ndryshime në pasqyrat financiare të filialeve për të përshatur politikat e tyre kontabël me ato të përdorura nga anëtarët e tjerë të Grupit.

(a) Bazat e konsolidimit

(i) Kombinimi i bizneseve

Në përputhje me SNRF 3 "Kombinimi i bizneseve", një kombinim biznesi është bashkimi i entiteve ose bizneseve të veçanta në të njëjtin entitet raportues. Nëse transaksioni përmbush kriterin e kombinimit të bizneseve, duhet të përcaktohet nëse kombinimi i bizneseve përfshin entitete nën të njëjtin kontroll. Në përputhje me SNRF 3, dy entitete janë nën kontroll të përbashkët, kur entitetet ose bizneset e kombinuara kontrollohen nga e njëjta palë (palët) si para edhe pas kombinimit të biznesit dhe kur kontrolli nuk është i përkohshëm (kalimtar).

Kombinimet e biznesit janë kontabilizuar duke përdorur metodën e përvetësimit në datën e përvetësimit, e cila është data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Kontrolli është aftësia për të udhëhequr politikat financiare dhe operative të një entiteti, pra për të siguruar përfitime nga aktivitetet e tij. Për vlerësimin e kontrollit, Grupi merr në konsideratë të drejtat e mundshme të votës, të cilat janë aktualisht të ushtrueshme.

Emri i mirë është tejkalimi i kostos së përvetësimit nga Grupi përtej interesit të Grupit në vlerën (zakonisht vlera e drejtë) e aktiveve, detyrimeve dhe detyrimeve të mundshme të identifikueshme të entitetit që përvetësohet. Emri i mirë që lind nga përvetësimet e biznesit matet në kosto siç është përcaktuar në datën e përvetësimit të biznesit, minus humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka. Për qëllimin e testimit të rënies në vlerë, emri i mirë i shpërndahet secilës prej njësjve gjeneruese të parasë të Grupit (ose grupeve të njësjve gjeneruese të parasë) që pritet të përfitojnë nga bashkimi i forcave të kombinimit.

Një njësi gjeneruese e parasë të cilës i është shpërndarë emri i mirë testohet për rënie në vlerë në baza vjetore, ose më shpesh kur ka tregues që njësjja mund të ketë rënie në vlerë. Nëse shuma e rikuperueshme e njësisë gjeneruese të parasë është më pak se vlera e saj kontabël, humbja nga rënia në vlerë njihet fillimisht për të ulur vlerën kontabël të çdo emri të mirë të njohur tek njësjja dhe pastaj tek aktivet e tjera të njësisë në bazë proporcionale mbi vlerën kontabël të çdo aktiviteti në njësi. Një humbje nga rënia në vlerë është njohur direkt në pasqyrën përmbledhëse të konsoliduar të të ardhurave të konsoliduara. Një humbje në vlerë që njihet për emrin e mirë nuk anulohet në periudhat pasuese. Në nxjerrjen nga përdorimi të njësisë gjeneruese të parasë, shuma e atribuar emrit të mirë përfshihet në përcaktimin e fitimit ose humbjes nga nxjerrja jasht përdorimi.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

a) Bazat e konsolidimit (vazhdim)

(ii) Filialet

Filialet janë entitete të cilat kontrollohen nga Grupi. Kontrolli ekziston atëherë kur Grupi në mënyrë direkte ose indirekte ka fuqi të drejtojnë politikat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë të fillë që të përfitojë të mira nga aktivitetet e tij. Për të vlerësuar kontrollin, merren në konsideratë të drejtat për të votuar të cilat janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Të ardhurat ose shpenzimet e filialeve që janë blerë ose mbyllur gjatë vitit janë përfshirë në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e përfundimit të tij. Totali i të ardhurave përmbledhëse të filialeve i atribuohet pronarit të Bankës dhe interesit jo kontrollues edhe nëse kjo rezulton në një gjendje deficieti për interesat jo kontrollues.

Grupi përgatit pasqyra financiare të konsoliduara dhe të veçanta në përputhje me SNRF dhe periudha raportuese është e njëjtë për të gjitha shoqëritë e Grupit.

Sipas natyrës së aktivitetit, filialet e Grupit kanë disa politika kontabël specifike të cilat detajohen në shënimin 3 (n) për Raiffeisen Leasing sh.a. dhe në shënimet 3 (r) dhe 3 (s) për Raiffeisen INVEST.

(iii) Eliminimi i transaksioneve gjatë konsolidimit

Balancat brenda Grupit dhe të ardhurat dhe shpenzimet e përcaktuara që lindin nga transaksionet brenda Grupit, eliminohen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e përcaktuara eliminohen në të njëjtën mënyrë si të ardhurat e përcaktuara, por deri në masën që nuk ka të dhëna për zhvlerësim.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kosto së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të vitit. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës reale. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe nuk ka rishikim të mëvonshëm.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kosoto e transaksionit dhe zbritjet ose primet të cilat janë një pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një aktiviteti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave përfshijnë interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar si dhe interesat nga letrat me vlerë të vlefshme për shitje të logaritura mbi bazën e normës së interesit efektiv.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktivitet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve kontabël, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to. Shpenzime të tjera nga komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(e) Të ardhurat neto nga tregtimi

Të ardhurat neto nga tregtimi përfshijnë fitimet minus humbje të lidhura me aktivitetet dhe detyrimet e tregtueshme, dhe gjithashtu të gjitha ndryshimet në vlerë të drejtë, të realizuara ose jo, interesin, dividendët dhe ndryshimet nga kurset e këmbimit.

(f) Pagesat e qirasë dhe shpenzime të tjera operative

Pagesat e bërë për qiranë operative janë njohur në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë afatit të qirasë. Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Përfitimet e punonjësve

- *Plan pensioni me kontribute të përcaktuara*

Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin. Grupi paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuar për pensione.

- *Leja vjetore e paguar*

Grupi njihet si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

- *Përfitime afat-shkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi. Një provigjion mund të regjistrohet për shumën që pritet të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para ose planet e pjesëmarrjes në fitime, nëse Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi, dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

a) Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës regjistrohen atëherë kur Grupi në mënyrë të dukshme ka vendosur të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur oferta është bërë, është e mundshme që do të pranohet, dhe numri i personave që do të pranojnë ofertën mund të matet në mënyrë të besueshme.

(h) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të konsoliduar të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave të konsoliduara për shkak të zërave të të ardhurave ose shpenzimeve që janë të taksueshme ose të zbritshme në vite të tjera dhe zërat që asnjëherë nuk janë të taksueshme ose të zbritshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore të pritshme në datën kur detyrimi do të shlyhet ose aktiviteti do të realizohet bazuar në normën tatimore sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferenca tatimore të zbritshme të mund të përdoren. Një pasiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktiviteti tatimor i shtyrë dhe pasivi tatimor i shtyrë rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur të realizohet respektivisht përfitimi apo detyrimi fiskal i lidhur me të. Taksa të tjera shtesë lidhur me dividendin njihen kur njihet edhe detyrimi për pagimin e dividendit.

Matja e pasiveve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyrojnë pasojat tatimore që do të vijonin nga mënyra në të cilën Grupi pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyer vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të tij.

(i) Aktivitetet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Huatë dhe parapagimet dhe depozitat njihen fillimisht me kosto në datën e krijimit. Të gjitha aktivitetet financiare të tjera fillimisht njihen në datën e tregtimit, datë në të cilën Grupi bëhet palë e kontratës.

(ii) Ç'rregjistrimi

Aktivitetet financiare ç'rregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Grupit ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose nëse Grupi i transferon aktivitetin financiar një pale tjetër, përmes një transakcioni ku të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit transferohen. Çdo interes në aktive financiare të transferuara që përfitohet ose i mbahet Grupit njihet si një aktiv ose detyrim i konsoliduar.

Detyrimet financiare ç'rregjistrohen nëse detyrimet e Grupit të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Grupi merr pjesë në transakcione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha risqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitetet e transferuara nuk ç'rregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha risqet dhe përfitimet përfshin huadhënien e letrave me vlerë, dhe transakcionet e riblerjeve.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i) Aktivet dhe detyrimet e financiare (vazhdim)

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi në këmbim ('swap'), transaksioni konsiderohet si një transaksion financiar i siguruar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në transaksione në të cilat Grupi as nuk mban dhe as nuk transferon risqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, e çregjistroshon aktivin nëse kontrolli mbi të humbet. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vete si aktive ose detyrime sipas rastit.

Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli Grupi vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së tij të vazhdueshme, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Grupi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

(iii) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(iv) Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar të tregut ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiare të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiare vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodot e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

Grupi përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiare të zakonshme e të thjeshta si opsionet, swap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të tilla instrumenta të dhënat për tu përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg.

(v) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Grupi ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregues të Grupit.

(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Grupi vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Grupi merr në konsideratë evidencat për zhvlerësim si për aktive specifike ashtu edhe në baza kolektive. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme trajtohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme të cilat specifikisht nuk kanë evidencat për zhvlerësim, trajtohen në grup për ndonjë zhvlerësim të ndodhur por të paidentifikuar ende. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta risku. Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagesa ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimin e një huaje, të dhëna që një huamarrës po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si për shembull ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi, ose kushte ekonomike që tregojnë për mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Grupi përdor modelimin statistikor të trendave historike të propabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rimarrjeve dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin manaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rimarrjes krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme. Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, rimarrja e zhvlerësimit pasqyrohet në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i) Aktivet dhe detyrimet e financiare (vazhdim)

(vii) Klasifikimi me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Grupi i klasifikon aktivet dhe detyrimet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes kur:

- Aktivet ose detyrimet trajtohen, vlerësohen dhe raportohen me vlerën e drejtë të tyre.
- Klasifikimi shmang ose ul në një masë të konsiderueshme një mospërputhje kontabël që në kushte të tjera do të ishte e pranishme.
- Aktivi ose detyrimi përmban një derivativ që modifikon në mënyrë të konsiderueshme flukset monetare që do të kërkoheshin në rast të kundërt mbi bazën e kushteve kontraktuale.

(j) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjëndje të pakushtëzuara të Bankës Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Grupi për administrimin e angazhimeve afat shkurtra.

Këto aktive mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar.

(k) Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme

Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Grupi ka kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e portofolit i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit ose për përfitime afatshkurtra.

Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë mbahen me vlerën e drejtë në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar, duke i kaluar koston e transaksionit në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave. Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme nuk rriklassifikohen pas rregjistrimit fillestar.

(l) Derivatët jo të tregtueshme

Derivatët e mbajtura për qëllime të administrimit të rrezikut përfshijnë të gjitha aktivet dhe detyrimet derivative të cilat nuk janë të klasifikuara si aktive ose detyrime të tregtueshme. Derivatët maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar. Kur një derivativ nuk është i tregtueshëm dhe nuk klasifikohet në një marrëdhënie mbrojtje (hedge) të kualifikuar, të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të tij njihen menjëherë në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave si një përbërës i të ardhurave të tregtimit neto.

Vlera e drejtë e swap-eve të normës së interesit është shuma e vlerësueshme që Grupi do të mund të përfitonte ose paguante për të përfunduar swap-in në datën e mbylljes së raportimit, duke marrë parasysh normat aktuale të interesit dhe besueshmërinë e homologëve të swap-it. Vlera e drejtë e kontratave të këmbimit të ardhshëm ('forward') të monedhave të huaja është çmimi i tyre i tregut në datën e raportimit, pra vlera aktuale e çmimeve të ardhshme ('forward') të kuotuar në treg.

(m) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Grupi nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Grupi është qiradhënës në një kontratë qiraje që transferon thaujse të gjitha rreziqet dhe të mirat e lidhura me pronësinë e një aktivi tek një qiramarrës, marrëveshja prezantohet brenda huave dhe paradhënieve.

Kur Grupi blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kyesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(n) Qiraja financiare

Një qira klasifikohet si qira financiare nëse ajo transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë nga qiradhënësi tek qiramarrësi dhe kështu të arkëtueshmet nga pagesat e qirasë janë trajtuar nga Grupi si ripagim i principalit dhe të ardhurave financiare për të rimbursuar dhe shpërblyer për investimet dhe shërbimet e Grupit. Çdo marrëveshje tjetër qiraje përveç qirasë financiare klasifikohet si qira e zakonshme.

Shumat për t'u marrë nga qiramarrësit njihen si të arkëtueshme me vlerën e investimit neto të Grupit në qiranë financiare. Pagesat minimale të qirasë nën qiratë financiare shpërndahen ndërmjet të ardhurave financiare dhe reduktimit të aktiveve të mbetura. E ardhura financiare shpërndahet në çdo periudhë gjatë jetës së qirasë në mënyrë që të prodhojë normë interesi konstante mbi shumën e mbetur të aktivitetit.

Pagesat e mundshme të qirasë kontabilizohen duke rishikuar minimumin e pagesave të qirasë mbi jetën e mbetur të qirasë kur konfirmohen rregullimet.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABEL (VAZHDIM)

(o) Letrat me vlerë

Investimi në letrat me vlerë matet me vlerën e tregut duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim kontabilizohet mbi bazën e klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë investime që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Grupi ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim, të cilat nuk janë klasifikuar si të disponueshme për shitje, apo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes dhe regjistrohen pas njohjes fillestare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit, do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i mbajtur për shitje dhe do ndalonte Grupin për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhën aktuale dhe për dy vitet pasuese.

(ii) Me vlerë të drejtë përmes pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave

Grupi mban disa letra me vlerë me vlerën e tregut, me ndryshimet në vlerë të njohura menjëherë në pasqyrën e konsolidura përmbledhëse të të ardhurave siç përshkruhet në politikën kontabel 3(i)(vii).

(iii) Letra me vlerë të vlefshme për shitje

Investime të disponueshme për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto. Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre.

Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e konsolidur përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në kapital deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, kur vlera progresive e njohur në kapital, kalon si fitim ose humbje në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave.

(p) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Grupi përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, dhe kostot e çmontimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të konsoliduara të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Grup, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave me anën e metodës lineare gjatë jetës së çdo aktivi afatgjatë material. Aktivitetet e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit. Toka nuk zhvlerësohet.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon:

	2011 (në vite)	2010 (në vite)
Ndërtesa	20	20
Kompjutera, ATM dhe pajisje informatike	4	4
Automjete	5	5
Investime në mjetet e marra me qira	2-4	2-4
Të tjera (pajisje zyre)	5	5

Jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(q) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale të blera nga Grupi njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivët afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave, bazuar në metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën aktivi është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e aktiveve afatgjata jomateriale është 4 vjet.

Shpenzimet e kërkimit, të kryera me qëllim përfitimin e një njohurie shkencore ose teknike regjistrohen si shpenzim në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(r) Fondi i pensione veve vullnetare Raiffeisen

Raiffeisen INVEST vepron si një Shoqëri administruese për një fond me kontribute të përcaktuara "Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen" ("Fondi"), i cili u miratua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më 18 tetor 2010.

Kërkesat e ligjit të ri nr. 10197 datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare", përfshijnë përgjegjësinë e Shoqërisë për të përgatitur pasqyra financiare të veçanta për Shoqërinë dhe Fondin.

Shoqëria administruese e Fondit të Pensioneve Raiffeisen ka bërë përgatitjet e duhura për të qenë në përputhje me ligjin e ri që nga data 1 janar 2011, duke përfshirë mbajtjen e librave të ndarë për veprimet e Shoqërisë dhe të Fondit. Për të arritur këtë, një sistem kompjuterik është blerë në mënyrë që të llogarisë çdo ditë parametrat e Fondit në përputhje me ligjin e ri.

Megjithatë, për shkak të pasigurive që lidheshin me kuadrin ligjor të raportimit dhe mungesa e politikës apo rregullores në lidhje me kërkesat e raportimit për pasqyrat financiare të Shoqërisë dhe Fondit në datën e përgatitjes dhe miratimit të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2010, pasqyrat financiare të veçanta nuk u përgatitën më 31 dhjetor 2010 dhe për këtë arsye veprimtaria dhe aktivet e Fondit u përfshinë në operacionet dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë. Pasqyrat e veçanta financiare të Shoqërisë Administruese dhe të Fondit janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011.

Në 30 nëntor 2011, Asambleja e Zakonshme e Aksionarit të Vetëm vendosi të ndryshojë objektin e aktivitetit të Shoqërisë në:

- administrimin e fondeve të pensionit vullnetar duke mbledhur dhe investuar fonde bazuar në ligjin nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar", si dhe në përputhje me parimet e shpërndarjes së rrezikut (diversifikimi), për qëllimin e sigurimit të përfitimeve të daljes në pension për personat që marrin pjesë në fondin e pensione veve. Shoqëria mund të ofrojë edhe shpërndarjen e pensione veve,
- për të krijuar dhe/ose administruar sipërmarrjet e investimeve kolektive bazuar në ligjin nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive",
- aktivitete të tjera të përcaktuara në ligjin nr. 10 198, datë 10 dhjetor 2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive".

Më 31 dhjetor 2011, aktivet neto të Fondit të Pensioneve Vullnetare Raiffeisen arrijnë shumën 73,865 mijë Lek (2010: 66,262 mijë Lek). Numri i njësisë të ofruara nga Fondi është 68,315 më 31 dhjetor 2011, me një çmim për njësi 1,081 Lek (2010: 66,262 njësi me çmim për njësi 1,000 Lek).

(s) Plani i kontributeve të përcaktuara (Fondet Vullnetare të Pensioneve)

Në një fond me kontribute të përcaktuara, shuma e përfitimeve të ardhme të pjesëmarrësve përcaktohet nga kontributet e paguara dhe fitimi nga investimet e fondit. Detyrimet njihen në pasqyrën e konsoliduar përmblendhëse të të ardhurave kur janë maturuar dhe paraqiten si interesa të kredituara të fondit të pensione veve nën të ardhurat nga investimi dhe të ardhurat nga transaksioni.

Fondi vepron në përputhje me ligjin nr. 10197, datë 10 dhjetor 2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar". Gjithashtu, strategjia investuese e aktiveve të Fondit Vullnetar të Pensioneve Raiffeisen bazohet në politikën e brendshme të investimeve të Shoqërisë Administruese dhe në rregulloren "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kurifi maksimal i investimeve të fondit të pensionit" e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqipëtare.

Më 31 dhjetor 2011 dhe 2010 portofoli i investuar përfshin obligacione qeveritare dhe bono thesari, depozita afatshkurtra në banka të nivelit të dytë dhe të tjera para dhe ekuivalentë të saj. Banka e Parë e Investime Shqipëri sh.a. vepron si bankë kustode e Fondit Vullnetar të Pensioneve Raiffeisen.

Vlera neto e aktiveve

Vlera neto e aktiveve është sa totali i aktiveve neto duke i zbritur detyrimet e Fondit.

Vlera e njësisë së Fondit të pensione veve

Vlera e njësisë është sa vlera neto e aktiveve e pjestuar me numrin e njësisë në datën e raportimit. Sipas politikës së Fondit, vlera hapëse e një njësisë ka qënë e barabartë me 1,000 Lek.

Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi përfshijnë të ardhura nga kuponat e obligacioneve dhe interesat e depozitave. Të ardhurat nga interesi paraqiten në bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(s) Plani i kontributeve të përcaktuara (Fondet Vullnetare të Pensioneve) (vazhdim)

Traifa për Shoqërinë Administruese

Fondi duhet ti paguajë Shoqërisë Administruese një tarife 3% (vjetore) mbi vlerën neto të aktiveve, shpenzim i cili llogaritet në baza ditore.

Fitim / humbje të realizuara dhe fitim / humbje të parealizuara

Fitimet / humbjet e realizuara njihen në bazë të shitjeve të letrave me vlerë që kanë një diferencë midis çmimit të ofruar dhe vlerë së principalit dhe interesve të maturuara të letrës me vlerë të blerë me prim ose zbritje. Këto diferenca njihen në pasqyrën e konsoliduar përmbljedhëse të të ardhurave kur ndodhin. Fitimet / humbjet e parealizuara njihen si pasojë e diferencës së kostos dhe vlerës së drejtë. Kur letrat me vlerë shiten, fitim/ humbjet e parealizuara transferohen në pasqyrën e konsoliduar përmbljedhëse të të ardhurave të asaj periudhe.

(t) Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet kryesore të financimit të Grupit.

Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktiviteti vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

Grupi klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(v) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbljedhëse të të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivitetin.

Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është ulur apo nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin apo amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

(x) Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjonet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para takse e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

(y) Standarde dhe interpretime efektive në periudhën aktuale

Rishikimet e mëposhtme për standardet ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë të vlefshme për periudhën aktuale:

- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Hiperinflacioni i rëndë dhe heqja e datave të përcaktuara për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Ndryshime në SNRF 7 “Instrumentat financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese”**- Transferimi i aktiveve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2011),
- **Rishikimi i SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”** – Taksa e shtyrë: Rimarrja e aktivitetit bazë (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2012 ose pas kësaj date),

Aplikimi i këtyre rishikimeve dhe standardeve e interpretimeve ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Grupit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(z) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar, por ende jo në fuqi:

- **SNRF 9 “Instrumentet Financiare”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2013 ose pas kësaj date). SNRF 9 “Instrumentet Financiare” u publikua nga BSNK më 12 nëntor 2010. Më 28 shtator 2011, BSNK ri-publikoi SNRF 9, duke shtuar kërkesa të reja mbi kontabilizimin e detyrimeve financiare dhe duke mbajtur nga SNK 39 kërkesat për çrregjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Standardi përdor një metodologji të vetme për të përcaktuar nëse aktivi financiar matet me kosto të amortizuar apo me vlerë të drejtë, duke zëvendësuar rregullat e shumta në SNK 39. Metodologjia e SNRF 9 bazohet mbi mënyrën se si një Shoqëri manaxhon instrumentat financiarë (sipas modelit të biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhjes së parasë së kontraktuar të aktivit financiar. Standardi i ri gjithashtu kërkon përdorimin e një metode zhvlerësimi, duke zëvendësuar metodat e ndryshme të zhvlerësimit në SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare adresojnë problemin e luhatjeve në fitim humbjet që lindin kur lëshuesi zgjedh ta vlerësojë borxhin me vlerën e drejtë. BSNK vendosi të mbajë vlerësimin aktual me kosto të amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke u kufizuar në ndryshimet e kërkuara për të adresuar problemet e vetë kreditimit. Me kërkesat e reja, Grupi që zgjedh të vlerësojë një detyrim me vlerën e drejtë do paraqesë pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë si pasojë e ndryshimeve në rrezikun e kreditimit, në të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 9 e publikuar pasqyron pjesën e parë të punës së BSNK në zëvendësimin e SNK 39 dhe lidhet me klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare të përkufizuara nga SNK 39. Në faza të mëtejshme, Bordi do adresojë zhvlerësimin dhe mbrojtjen [hedge]. Përfundimi i projektit pritet në mes të 2011. Aplikimi i fazës së parë të SNRF 9 kryesisht do ketë efekt në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Grupi aktualisht po vlerëson efektin e aplikimit të SNRF 9, gjithsesi, efekti do varet nga aktivet që do ketë Grupi në datën e aplikimit, ndaj aktualisht nuk mund të kuantifikohet efekti.
- **SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013), publikuar nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 10 zëvendëson udhëzimin e konsolidimit në SNK 27 Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale dhe KIS 12 Konsolidimi – Njësitë ekonomike për qëllime të veçanta, duke prezantuar një model të vetëm konsolidimi për të gjitha njësitë në bazë të kontrollit, pavarësisht nga natyra e investitorit (p.sh., nëse një njësi kontrollohet nëpërmjet të drejtave të votës të investitorëve ose nëpërmjet marrëveshjeve të tjera kontraktuale siç është e zakonshme në njësitë për qëllime të veçanta). Sipas SNRF 10, kontrolli është bazuar nëse një investitor ka 1) pushtet mbi të investuarin, 2) ekspozim, ose të drejta, për kthim të ndryshueshme nga përfshirja e tij me të investuarin, dhe 3) aftësinë për të përdorur pushtetin e tij mbi të investuarin që të ndikojë shumë e kthimeve.
- **SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNRF 13 “Matja e vlerës së drejtë”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNK 27 (rishikuar në 2011) “Pasqyrat financiare individuale”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNK 28 (rishikuar në 2011) “Investime në filial dhe shoqëri të përbashkëta”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshimet në SNRF 1 “Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë”**- Huatë Qeveritare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013)
- **Ndryshime në SNRF 7 “Instrumentat financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese”**- Netimi i aktiveve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2011),
- **Ndryshime në SNRF 9 “Instrumentat Financiare” dhe SNRF 7 “Instrumentat Financiare-Shpjegime”** Data e detyrueshme e hyrjes në fuqi dhe paraqitjet kalimtare, publikuar nga BSNK më 16 dhjetor 2011. Ndryshimet ndryshojnë datën e detyrueshme të hyrjes në fuqi nga 1 janar 1013 në 1 janar 2015. Ndryshimet gjithashtu sigurojnë lehtësim nga kërkesat për të riparaqitur pasqyrat financiare krahasues për efekt të zbatimit të SNRF 9. Ky lehtësim ishte fillimisht në dispozicion të shoqërive që zgjedhën të zbatojnë SNRF 9 para vitit 2012. Në vend të kësaj, paraqitje shtesë kalimtare do të kërkojnë për të ndihmuar investitorët të kuptojnë efektin që zbatimi fillestar i SNRF 9 ka në klasifikimin dhe matjen e instrumentave financiarë.
- **Ndryshimet në SNRF 1 “Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë”**- Paraqitja e zërave e të ardhurave përmbledhëse të tjera (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2012),
- **Ndryshime në SNK 19 “Përfitimet e punonjësve”** – Përmirësime të kontabilizimit për përfitimet pas punësimit të punonjësve (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

z) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara (vazhdim)

- **Ndryshime në SNK 32 “Instrumentat Financiare: paraqitja”** – Kompensimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime “Përmirësimet e IFRS-ve (2012)”** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 17 maj 2012 (SNRF 1, SNK 1, SNK 16, SNK 32, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (rishikimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2013).
- **KIRFN 20 “Shpenzimet e nxjerrjes në fazën e prodhimit të një sipërfaqje miniere”** – (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013).

Grupi ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Përveç siç shpjegohet më lart lidhur me SNRF 9, Grupi parashikon se aplikimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e tij financiare të konsoliduara në periudhën e aplikimit fillestar.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Drejtimi i Grupit diskuton me Komitetin e Kontrollit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Grupit, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 5).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Provizione për humbje nga kreditë

Aktivët e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivitetit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(i)(vi).

Përbërësi specifik në totalin e fondit të zhvlerësimit të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të flukseve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto flukse të parave drejtimi gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e flukseve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavaruar nga rreziku i kreditit. Fondi i zhvlerësimit të portofolit mbulon humbje nga kreditë dhënë klientëve me karakteristika ekonomike të ngjashme, kur nuk ka ndonjë evidencë të dukshme për humbje, por humbja mund të ketë ndodhur dhe pse e paidentifikueshme në datën e pasqyrave financiare. Një element i fondit kolektiv për zhvlerësimin e kredive është rreziku i vendit ku është dhënë kredia. Në vlerësimin e nevojës për fond kolektiv, drejtimi konsideron faktor si cilësia e kreditimit, madhësia e portofolit, përqëndrimi si dhe faktorë ekonomik. Në mënyrë që të vlerësohet fondi i kërkuar, janë bërë supozime për të përcaktuar se si janë modeluar humbjet dhe për të përcaktuar parametrat e kërkuar, bazuar në të kaluarën ose nga kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e vlerësimit të fondit kolektiv të zhvlerësimit varet nga sa të matshme janë flukset e ardhshme të projektuara nga aktiviteti dhe supozimet dhe parametrat e përdorura në modelin e vlerësimit.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë që paraqet rëndësinë e të dhënave të marra në përcaktimin e vlerësimit, të përshkruara si më poshtë:

- **Niveli 2:** Teknika vlerësimi të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme, qoftë në mënyrë direkte (si çmimet) ose në mënyrë indirekte (si për shembull të dhëna që rrjedhin prej çmimeve). Kjo kategori përfshin investime të vlerësuara duke përdorur: çmime të kuotuar të tregut në tregje aktive për instrumenta të ngjashëm; çmime të kuotuar për instrumenta identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë në mënyrë direkte ose indirekte të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohet në çmimet e kuotuar të tregut apo në kuotimet e tregtuesve. Për të gjithë instrumentët e tjerë financiarë, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi siç përshkruhen në politikën kontabël 3(i)(iv). Për instrumentët financiarë që kanë treg financiar, por jo aktiv dhe çmimi i tregut nuk është transparent mjaftueshëm, vlera është më pak objektive dhe kërkon shkallë variabël gjykimi në varësi të likuiditetit, përqëndrimit, pasigurisë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Grupin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Grupit ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Grupit.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Grupit, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të riskut. Të gjitha komitetet përbëhen nga anëtarë ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi Drejtues.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Grupi, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Grupi, nëpërmjet trainimeve, standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Grupi. Komiteti i kontrollit mbështetet nga kontrolli i brendshëm i Grupit për të kryer funksionet e veta. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

Zhvillimet aktuale

Grupi operon në kushtet e një zhvillimi dinamik të një krize financiare dhe ekonomike. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative të pozicionit financiar të Grupit. Drejtimi i Grupit performon çdo ditë monitorimin e pozicioneve të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare financiare, duke vënë në zbatim praktikat më të mira bankare. Drejtimi është i bazuar në analizat e fitimit, likuiditetit dhe kostos së fondeve dhe merr masa të përshtatshme në lidhje me kreditimin, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe rrezikun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative të krizës globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Grupi i përgjigjet ndryshimeve të tregut, duke mbajtur një kapital dhe një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm.

(b) Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare nëse klienti, apo pala e instrumentit financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime raportimi të administrimit të kredisë, Grupi konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori). Për qëllime të administrimit të rrezikut, rreziku i kredisë nga letrat me vlerë të tregtueshme trajtohet në mënyrë të pavarur, por raportohet si një komponent i ekspozimit të riskut të tregut.

Administrimi i rrezikut të kreditimit

Bordi i Drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kreditimit të Bankës. Një divizion i veçantë i administrimit të rrezikut të kreditimit, i cili raporton te Komiteti i Kreditimit, është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kredisë duke përfshirë:

- Formulimin e politikave të kreditimit duke u konsultuar me njësitë e biznesit, rreth kërkesave për kolateral, vlerësimin e kredive, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.
- Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve të kreditimit. Komiteti i Kreditimit ose Bordi Drejtues i Grupit ka në dorë kufizimet për sa i përket autorizimeve të ndryshme.
- Mbikqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Grupi vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, përpara se facilitetet të jenë të angazhuara ndaj klientëve nga njësitë përkatëse të biznesit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces rishikimi.
- Të kufizojë ekspozimin ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive (për huatë dhe parapagimet), bandën e klasifikimit të kredive dhe nivelin e kreditimit të institucionit financiar, likuiditetin e tregut dhe ndaj shteteve të ndryshme (për investimet në letra me vlerë).
- Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Grupit në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Grupit. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësim

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kreditimit. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut konsiston në dhjetë kategori të cilat reflektojnë shkallën e rrezikut të mospagimit dhe disponibilitetin e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të rrezikut të kreditimit. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e rrezikut u takon Drejtuesvëve përkatës që japin aprovimin për kredinë. Kategoritë e rrezikut janë subjekt i vëzhgimeve nga Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kreditimit të Grupit.

- Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industritë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produkteve. Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kredisë merr dhe shqyrton rregullisht raporte mbi cilësinë e kreditimit dhe ndërmerr veprime përkatëse korrigjuese.
- Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësi të specializuara njësite të biznesit për të zhvilluar praktikatat më të mira për administrimin e rrezikut të kreditimit në të gjithë Grupin.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikat dhe procedurat e Grupit për administrimin e rrezikut të kreditimit. Kontrolli i brendshëm kryen në mënyrë të rregullt kontrolle ndaj njësite të biznesit dhe divizionit të administrimit të rrezikut.

(iv) Investime në letra me vlerë

	Investime të mbajtura për tregtim		Investime të mbajtura deri në maturim	
	2011	2010	2011	2010
Pa vonesa dhe të pazhvlërësuar (klasifikimi për qëllime të brendshme)				
Klasifikimi i vendit: B4	39,202,048	38,668,174	105,760,202	95,361,970
Vlera kontabël	39,202,048	38,668,174	105,760,202	95,361,970

(v) Hua dhe paradhënie klientëve

	Hua dhe paradhënie klientëve	
	2011	2010
Të zhvlerësuar individualisht		
Shkalla 5: Të zhvlerësuar	12,930,870	13,756,492
Vlera Bruto	12,930,870	13,756,492
Provizjon për zhvlerësim	(9,294,945)	(7,371,477)
Vlera kontabël (A)	3,635,925	6,385,015
Provizjone për humbjet bazuar në portofol		
Shoqëritë		
Shkalla 1	428,255	1,779,924
Shkalla 1.5	4,952,394	2,455,105
Shkalla 2	9,096,202	6,996,709
Shkalla 2.5	9,923,276	6,159,445
Shkalla 3	7,861,843	8,883,553
Shkalla 3.5	30,023,186	27,622,333
Shkalla 4	19,655,201	10,996,767
Shkalla 4.5	11,359,095	5,662,388
Shkalla 5 (pa klasifikuar)	5,312,078	3,094,198
	98,611,530	73,650,422
Individë	23,449,830	20,269,831
Vlera bruto	122,061,361	93,920,253
Provizjon për zhvlerësim	(1,571,004)	(1,906,837)
Vlera kontabël (B)	120,490,357	92,013,416
Me vonesë por jo të zhvlerësuar përfshin:		
30-60 ditë:	8,687,743	4,062,973
60-180 ditë:	5,430,914	5,920,829
Vlera kontabël	14,118,658	9,983,802
Vlera kontabël totale (A+B)	124,126,282	98,398,431

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Grupi ka përcaktuar se është e mundur që mos të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe principalit të huasë në bazë të kushteve të kontratës. Këto hua vlerësohen me shkallën 0.5 deri në 5 në sistemin e brendshëm të kategorizimit të rrezikut.

Hua me vonesë por jo të zhvlerësuara

Hua dhe letra me vlerë ku pagesat e interesit janë me vonesë por që Grupi beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të shkallës së garancive / kolateralit të vlefshëm dhe /ose shkallës së arkëtimit të shumës së huasë.

Hua me kushte të rinegociueshme

Hua me kushte të rinegociueshme janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Grupi ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar, qëndron në të njëjtën kategori, edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet.

Fondi për zhvlerësim

Grupi vendos një provigjon për humbjet nga zhvlerësimet që përfaqëson vlerësimin e Grupit për humbjet e ndodhura të portofolit. Përbërësit kryesorë të këtij provigjoni janë, një komponent për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme individuale, dhe një provigjon i përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësim.

Politikat e nxjerrjes jashtë përdorimit

Grupi nxjerr jashtë përdorimi një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga zhvlerësimi) kur Komiteti i Kredive me probleme të Grupit vendos që huatë/ letrat me vlerë janë të pa-arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhja e ngjarjeve të konsiderueshme të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

Më poshtë është paraqitur analiza e shumave neto dhe bruto (e provigjoneve për zhvlerësim) të aktiveve individualisht të zhvlerësuara, sipas shkallës së rrezikut.

	Hua dhe paradhënie klientëve	
	Bruto	Neto
31 dhjetor 2011		
<i>Individualisht të zhvlerësuara</i>		
Të ardhurat nga interesat sipas kategorisë janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Hua dhe paradhënie klientëve	10,679,349	10,014,180
Investime në letra me vlerë	8,596,747	8,458,365
Depozita bankare	699,526	613,975
Marrëveshje të riblerjes	370	-
Totali	19,975,992	19,086,520

25. SHPENZIME PËR INTERESA

Shpenzimet për interesa sipas kategorive janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Klientët	7,098,295	6,179,096
Marrëveshje të anasjallta të riblerjes	448,053	820,057
Bankat	127,102	106,697
Totali	7,673,450	7,105,850

26. TË ARDHURA NGA KOMISIONET

Të ardhurat nga komisionet përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Transfertat e fondeve	853,175	879,800
Aktiviteti huadhënës	241,877	253,038
Shërbime të tjera bankare	310,648	252,800
Totali	1,405,700	1,385,638

27. SHPENZIME PËR KOMISIONET

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Transfertat e fondeve	245,371	245,503
Aktiviteti huadhënës dhe i garancive	6,115	11,768
Shërbime të tjera bankare	55,734	20,228
Totali	307,220	277,499

28. TË ARDHURA NETO NGA TREGTIMI

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë	1,742,357	1,981,021
Fitime nga kursi i këmbimit	238,327	111,337
Totali	1,980,684	2,092,358

29. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Të ardhura të tjera	81,127	134,940
Shpenzime të tjera	(182,961)	(130,928)
Totali	(101,834)	4,012

Në "Të ardhura të tjera" përfshihen të ardhurat nga shitja e aktiveve të qëndrueshme në shumën 36,525 mijë Lek (2010: 14,754 mijë Lek). Shpenzime të tjera përfshijnë tatimin në burim në shumën 26,144 mijë Lek (2010: 14,112 mijë Lek) dhe gjoba dhe komisione në shumën 99,638 mijë Lek (2010: 10,194 mijë Lek).

30. PRIMI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Duke filluar nga 18 tetori 2002 legjislacioni ka përcaktuar se bankat duhet të paguajnë një prim për sigurimin e depozitave. Primi bazohet në normën 0.5% në vit, e pagueshme çdo 3-mujor dhe llogaritet si përqindje mbi balancat mesatare ditore të depozitave deri në 2,500,000 Lek (2010: 2,500,000 Lek) për individët, për periudhën nga tetori deri në dhjetor të vitit të mëparshëm.

31. SHPENZIME PËR PERSONELIN

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Pagat	1,926,041	1,751,581
Sigurimet shoqërore	232,810	202,325
Shpenzime për trainimin e personelit	47,779	39,341
Kosto të tjera të personelit	12,941	47,574
Totali	2,219,571	2,040,820

32. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Shpenzime për zyrat	551,228	431,378
Shpenzime për IT	516,441	355,715
Shpenzime marketingu	324,672	289,466
Shpenzime të ndryshme administrative	145,543	135,614
Tarifa konsulence dhe ligjore	115,341	166,251
Shpenzime për kancelari	84,357	54,320
Shpenzime për komunikim	68,020	60,424
Shpenzime për makinat	49,331	34,695
Shpenzime udhëtimi	32,700	24,014
Shpenzime sigurie	23,650	25,900
Totali	1,911,283	1,577,777

Në "Tarifa konsulence dhe ligjore" përfshihet edhe tarifa e administrimit të zyrës qendrore, që arrin në shifrën 7,641 mijë Lek në 2011 (2010: 76,150 mijë Lek).

33. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri matet me 10% (2010: 10%) të të ardhurave të tatueshme.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010
Tatimi aktual	780,430	761,939
Tatimi i shtyrë	(9,222)	(67,867)
Totali	771,208	694,072

Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit i llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor			
	Norma e taksës	2011	Norma e taksës	2010
Fitimi para tatimit		7,856,490		6,055,051
Tatimi i llogaritur me 10% (2010: 10%)	10.0%	785,649	10.0%	605,505
Shpenzime të pazbritshme	0.5%	(6,930)	0.5%	88,567
Diferenca kohore që nuk janë njohur	0.0%	(7,511)	0.0%	-
Zbritje në normën e tatimit	-	-	-	-
Tatim Fitimi	10.5%	771,208	10.5%	694,072

34. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

	31 dhjetor 2011			31 dhjetor 2010
	Lek	Monedhë e huaj	Totali	Totali
<i>Detyrime të mundshme</i>				
Garanci bankare të lëshuara	802,076	6,860,678	7,662,754	4,590,224
Letër kredi	391,008	2,938,207	3,329,215	485,827
Linja të papërdorura krediti	3,890,995	4,034,812	7,925,807	7,606,007
Detyrime qira financiare	-	-	-	3,960
Çështje gjyqësore	31,778	-	31,778	43,005
Totali	5,115,857	13,833,697	18,949,554	12,729,023
<i>Angazhime (Aktive)</i>				
Garanci bankare të marra	23,298	419,069	442,367	2,652,161
Angazhime për qeratë operative	116,004	1,077,373	1,193,377	698,540
Totali	139,302	1,496,442	1,635,744	3,350,700

Pjesa më e madhe e garancive bankare dhe letër kredive të mësipërme janë për periudha kohore më pak se një vit, dhe kolateralizohen nga depozitat e bllokuara të klientëve.

33. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME (VAZHDIM)

Çështjet gjyqësore

Më 31 dhjetor 2011 dhe 31 dhjetor 2010 Grupi paraqitet i përfshirë në pretendime dhe procese gjyqësore të cilat konsiderohen të një natyre normale për aktivitetin e tij. Shkalla e këtyre pretendimeve dhe proceseve gjyqësore korrespondon me shkallën e pretendimeve dhe proceseve gjyqësore gjatë vitit të kaluar. Drejtimi i Grupit është i mendimit se Grupi nuk do të pësojë humbje materiale si rezultat i çështjeve ligjore pezull më 31 dhjetor 2011 dhe më 31 dhjetor 2010.

Angazhimet për qiratë

Grupi ka hyrë në angazhime të pakthyeshme qiraje për Drejtorinë e Përgjithshme dhe degët. Angazhime të tilla më 31 dhjetor 2011 dhe 31 dhjetor 2010 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Jo më vonë se 1 vit	379,649	222,480
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet	762,742	476,060
Më vonë se 5 vjet	50,986	-
Totali	1,193,377	698,540

35. PALËT E LIDHURA

Kompania mëmë dhe filialet e tyre

Grupi është palë e lidhur me Raiffeisen Bank International AG, Raiffeisen Zentralbank Osterreich Aktiengesellschaft (RZB AG), dhe me filialet e tyre.

Vlerat agregate të transaksioneve të kryera me këto entitete dhe gjendjet e mbetura janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2010
Detyrime nga:		
Raiffeisen Bank International AG	14,170,288	2,679,404
Raiffeisen Bank Kosovo	635	4,585
Aktive total	14,170,923	2,683,989
Detyrime ndaj:		
Raiffeisen Bank International AG	(377,850)	(410,195)
Raiffeisen Bank Kosovo	(10,578)	-
Detyrime total	(388,428)	(410,195)

Vlera agregate e detyrimeve të mundshme të Grupit ndaj shoqërive të lidhura është 908,110 mijë Lek më 31 dhjetor 2011 (31 dhjetor 2010: 1,100,442 mijë Lek) dhe përfaqëson garanci bankare dhe letra të kredisë.

	2011	2010
Të ardhura nga interesat, neto		
Raiffeisen Bank International AG	57,426	(3,611)
Raiffeisen Bank Kosovo	(28)	37
Të ardhura nga komisionet, neto		
RZB AG		(13,300)
Raiffeisen Bank International AG	(17,299)	816
Raiffeisen Bank d.d. Bosna i Hercegovina	1,001	(5)
Raiffeisen Bank Kosovo	-	(10)
Raiffeisen Bank Bulgaria Ead	-	(29,614)
Tatra Banka	(17,559)	(54,766)
Ukrainian Processing Center	(53,098)	(66,253)
Regional Card Processing Centre,s.r.o	(68,771)	(13,300)
Blerje aktivesh dhe shpenzime administrative		
RZB AG	(150)	(36)
Raiffeisen Bank International AG	(225,006)	(193,568)
Tatra Banka	(1,925)	(2,397)
RSC Raiffeisen Daten Service Center GmbH	(304)	(273)
Centralised Raiffeisen International Services & Payments S.R.L.	(20,847)	(10,807)
Raiffeisen Leasing International G. m.b.H	(1,405)	(1,568)
Transaksionet neto	(347,965)	(388,655)

Administratorët

Vlerat agregate të transaksioneve dhe balancave në fund të vitit lidhur me administratorët janë si më poshtë:

	2011	2010
Pasqyra e pozicionit financiar		
Detyrimet nga administratorët	103,782	81,977
Detyrimet ndaj administratorëve	(54,070)	(15,508)
Gjendjet neto nga administratorët	49,712	66,469
Shpenzime		
Pagat, rroga fikse, shpërblimet		
Totali	(197,991)	(169,060)

Filiali

Banka zotëron 75% të aksioneve të Raiffeisen Leasing sh.a. Rrjedhimisht, Banka e konsolidon këtë filial. Banka zotëron 100% të aksioneve të Raiffeisen Pensions sh.a. Rrjedhimisht, Banka e konsolidon këtë filial.

36. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 25 prill 2012 dha miratimin paraprak për transferimin e 100% të aksioneve të pjesëmarrësve në kapitalin aksioner të Raiffeisen Bank Sh.a, Shqipëri, nga Raiffeisen Bank International AG Austria tek Raiffeisen SEE Region Holding GmbH Austria. Pas këtij aprovimi, Banka ka filluar të ndjekë kërkesat ligjore për regjistrimin e aksionerëve të rinj.

Më 31 dhjetor 2011, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare aprovoi "Raiffeisen Prestigj", shoqërinë e re të fondeve të investimit e cila do të administrohet nga Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive. Raiffeisen Prestigj u krijua në shkurt 2012.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullim apo prezantim në pasqyrat financiare të konsoliduara.



Shkodra është një nga qytetet i cili ka patur vëmendjen e veçantë të Bankës për sektorin arsimor (si rikonstruksioni i dhomës së muzikës në shkollën Prenk Jakova), Kulturë (edicioni i dytë i filmit vizatimor për fëmijë) etj.

Raiffeisen Leasing

Raiffeisen Leasing SHA, themeluar në Prill të vitit 2006, është regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë numër 35733, datë 15.05.2006, me aksionerë Raiffeisen Bank SHA me 75% të aksioneve dhe Raiffeisen Leasing International GmbH me 25% të aksioneve.

Mbas 5 viteve veprimtarie në Shqipëri, Raiffeisen Leasing mbetet lideri kryesor në tregun e lizingut. Aktiviteti i kompanisë është të sigurojë financimin e aseteve nëpërmjet lizingut financiar. Gjatë viti 2011, megjithëse industria e investimeve u përball me sfida të mëdha, Raiffeisen Leasing ka patur një tjetër vit rritjeje, me një rritje prej më shumë se 15 % në total aktivesh dhe vlera totale e financimit ka arritur mbi 16,9 milion Euro, duke shënuar edhe vitin më të mirë mbas krizës globale më 2008.

Të gjithë produktet e lizingut u janë ofruar segmenteve të biznesit si korporatat dhe bizneset e mesme, ndërkohë që individët e përdorin kryesisht për makina personale.

Rritja e klientelës, kreativiteti dhe produkte të fokusuar për klientet, fitimi i qëndrueshëm, raporti konkurrues shpenzime/ të ardhura; na vendosin në një pozicion shumë të mirë për tu zgjeruar më tej si lider në tregun e lizingut në Shqipëri.

Portofoli ynë përfshin produkte të ndryshme lizingu duke filluar nga autoveturat deri tek makineritë e rënda, pajisjet dhe linjat e reja teknologjike. Financimi i autoveturave dhe makinave të punës është rritur me 38 % krahasuar me vitin e kaluar. Fokus në vitin 2011 ka qenë financimi i linjave të reja për prodhimin e produkteve të ndryshme të konsumit, autobuse të standarteve të fundit si për shërbimin urban, ashtu edhe për atë ndërkombëtar, financimin e flotave për shërbim taksit që çon në rritjen e standarteve të mjeteve për transportin publik. Makineritë e ndërtimit vazhdojnë të mbeten në objektivat tona, pavarësisht faktit që viti që kaluam ka qenë shumë i vështirë për këtë industri; gjë që u reflektua edhe në kërkesën e ulët të këtij sektori në investimet për mjete dhe makineri të reja. Gjithsesi, pjesa më e madhe e portofolit është përqëndruar pikërisht në këtë segment, ku Raiffeisen Leasing është edhe lider i diskutueshëm.

Pjesë e aktivitetit tonë është edhe rimarketimi e rishitja e mjeteve. Përsa i përket rishitjes kemi implementuar procedura që na kanë pozicionuar si ekspert për vendosjen e standardeve në treg. Gjithsesi kompania ka përdorur njohuritë dhe eksperiencën e Raiffeisen Leasing International si dhe të kompanive të tjera të lizingut që operojnë në rajon lidhur me produktet dhe shërbimet e qirasë financiare, si dhe në fushën e marketingut. Për më tepër, kompania ka akses të plotë në rrjetin e madh të furnitorëve ndërkombëtarë të makinave me tonazh të rëndë, makinerive dhe paisjeve, me të cilët Grupi Raiffeisen ka lidhje të qëndrueshme, në dobi të klientëve ekzistues dhe potencialë të kompanisë për realizimin e planeve të tyre investuese.

Raiffeisen Leasing finalizoi procesin e dërgimit të portofolit të lizingut në Regjistrin e Kredive. Kjo do të ndihmojë në njohjen më të mirë të klientëve me probleme dhe rritjen e cilësisë së portofolit dhe fokusimin në financimin e klientëve cilësorë.

Punonjësit e kualifikuar në kompani janë themeli kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm të Raiffeisen Leasing. Menaxhimi dëshiron të përfitojë nga kjo mundësi për ti falenderuar për punën e bërë në interes të kompanisë dhe partnerëve të biznesit.

Raiffeisen Leasing publikon një gamë të gjerë materialesh si të printuar ashtu edhe në faqen e internetit www.raiffeisen-leasing.al. Gjatë vitit 2011 Raiffeisen Leasing SHA ka ndërmarrë fushata marketingu, kryesisht të bazuar dhe të koordinuar me politikat dhe aktivitetet e marketingut të konçesionerëve vendas si partnerët tanë kryesorë në biznes.

Perspektivat për vitin 2012

Fakti që kompania është lider në tregun e lizing për vite me rradhë është së pari si rezultat i shumë viteve eksperiencë dhe gamës së gjerë të aftësive për vlerësimin e klasave të ndryshme asetesh, por gjithashtu edhe përgjegjësisia si partnerë biznesi dhe duke patur këtë parasysh misioni ynë mbetet që Raiffeisen Leasing të jetë lider në tregun e qirasë financiare në Shqipëri duke ofruar një paketë të plotë të produkteve lizing, duke kënaqur plotësisht nevojat e klientëve dhe duke kontribuar në zhvillimin e ekonomisë shqiptare nëpërmjet financimit të teknologjisë së re dhe bashkëkohore, makinerive dhe paisjeve.

Në të ardhmen do të shtojmë fokusin në rritjen e penetrimit të klientëve Paga +, dhe për këtë ne do të mbështetemi në rrjetin gjithëpërfshirës të bankës Raiffeisen dhe gjithashtu nga vitet e eksperiencës që kemi fituar në treg. Perfeksionimi i cilësisë së shërbimit të Raiffeisen Leasing SHA, si dhe shpejtësia e procesimit dhe aprovimit, mbetet një nga prioritetet e kompanisë .

Përbushja e objektivave tona do të ketë si mbështetje të rëndësishme edhe marketingun intensiv, aktivitetin e shitjeve në mënyrë direkte dhe indirekte,

Përbushja e objektivave tona do të ketë si mbështetje të rëndësishme edhe marketingun intensiv, aktivitetin e shitjeve në mënyrë direkte dhe indirekte.

Rreth Raiffeisen Invest sh.a

Raiffeisen INVEST sh.a është Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, dikur e njohur si Raiffeisen Pensions sh.a. dhe ku aksioneri i vetëm është Raiffeisen Bank sh.a. Shoqëria ka marrë licensën për administrimin e fondeve të investimit në 13 Dhjetor 2011, dhe si rrjedhojë ndryshoi edhe emrin e saj ligjor.

Raiffeisen INVEST sh.a do të menaxhojë fondet e investimeve, krahas fondeve të pensionit vullnetar.

Menaxhimi i shoqërisë

Raiffeisen INVEST sh.a menaxhohet nga Këshilli i Administrimit i përberë nga 7 anëtare, 5 prej të cilëve janë anëtare jo ekzekutive, ndërsa dy janë anëtarë ekzekutive.

Këshilli i Administrimit

Anëtarët jo-ekzekutive

Z. Serge Guay – Kryetar

Zj. Christa Bernbacher – zv. Kryetare

Zj. Barbora Valkova - anëtare

Zj. Alda Shehu – anëtare

Zj. Elona Koçi – anëtare

Anëtarët ekzekutive

Zj. Majlinda Gjata – Administratore e Përgjithshme

Zj. Gentiana Gjonça – zv.Administratore e Përgjithshme

Z. Serge Guay është Drejtor i Shitjes dhe Shpërndarjes në Bankën Raiffeisen.

Zj. Bernbacher është Drejtore Ekzekutive e Raiffeisen International Funds Consulting Company, në Vjenë.

Ekspierenca dhe ekspertiza që Z. Guay dhe Zj. Bernbacher sjellin në Këshillin e Administrimit është një kontribut shumë i vlefshëm për zhvillimin e Shoqërisë Administruese, menaxhimin e Fondeve dhe zhvillimin e produkteve të investimeve në Shqipëri. Këshilli i Administrimit mblidhet të paktën tre herë në vit dhe mund të ketë mbledhje të tjera shtesë sipas nevojave të biznesit.

Administrimi i fondeve të pensionit

Raiffeisen INVEST sh.a është një nga tre kompanitë private të administrimit të fondeve të pensionit vullnetar në Shqipëri. Kompania ka nën menaxhim vetëm një fond pensioni të quajtur "Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen".

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.10197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensionit Vullnetar", më datë 15 Janar 2010, u krijua një kuadër i ri ligjor për funksionimin e shoqërive private të pensionit.

Një nga ndryshimet themelore është ndarja e asetëve të kompanisë nga asetet e Fondeve që ajo administron.

Për herë të parë u krijua roli i bankës depozitare si një palë e pavarur e cila i raporton Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare përputhshmërinë e aktivitetit të Shoqërisë Administruese me kuadrin ligjor dhe kushtet e kontratës së lidhur me klientët.

Këto kërkesa ligjore të imponuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e interesave të klientëve të cilët investojnë në fondin e pensionit.

Ndarja e asetëve dhe roli që luan banka depozitare fuqizojnë pozicionin unik të anëtarëve të fondit si pronarë të titujve të investuar prej tyre, duke i dhënë atyre maksimumin e përfitimit nga investimi i kryer prej fondit. Performanca e asetëve të fondit është krejtësisht e ndarë nga performanca e kompanisë menaxhuese, nga performanca e aksionereve të tyre si edhe nga performanca e bankës depozitare. Me fjalë të tjera, anëtari në një fond pensioni, nuk mbart asnjë risk prej pjesëmarrësve në procesin e investimit, përveç riskut të vetë investimit.

Raiffeisen INVEST sh.a ishte kompania e parë e cila plotësoi kërkesat ligjore duke qenë plotësisht në përputhje me Ligjin që nga 1 Janari 2011. Kjo i dha mundësi klientëve të përfitojnë nga lehtësitë fiskale, pasi kontributi në fondin e pensionit vullnetar privat është një shpenzim i zbritshëm nga taksat si për individët që kontribuojnë nga të ardhurat e tyre, ashtu edhe për punëdhënësit që sponsorizojnë punonjësit e tyre.

Në 2011, shoqëria administruese krijoi edhe Web portalin, duke i dhënë mundësinë klientëve të aksesojnë llogarinë e tyre on-line. Gjithashtu çdo ditë në faqen e internetit publikohet çmimi ditor i kuotës.

Regjimi fiskal mbi kontributet në fondin e pensionit

Ligji nr. 10197 datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" parashikon një sërë lehtësirash fiskale për individët dhe kompanitë që anëtarësohen në një fond pensioni.

Individët:

- Kontributi i bërë nga çdo anëtar në një fond pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi
- Kufiri maksimal për lehtësitë tatimore mbi kontributet vjetore, për anëtarët nën 50 vjeç është vlera më e vogël që del nga krahasimi i shumës 200 000 ALL/në vit dhe 15% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit
- Kufiri maksimal për lehtësitë tatimore, për anëtarët mbi 50 vjeç është vlera më e vogël që del nga krahasimi i shumës 250 000 ALL/vit dhe 25% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit
- Çdo pagesë e marrë nga anëtari i fondit, si një shumë e menjëherëshme apo si pagesë periodike do të tatohet me tatimin mbi të ardhurat personale, me normën e zbatueshme në çastin e pagesës

Kompanitë

- Kontributet e bëra nga kompanitë (punëdhënësit) në interes të punonjësve të tyre në një plan pensioni profesional, konsiderohen shpenzime të zbritshme deri në shumën vjetore 250,000 ALL për çdo punonjës.
- Lidhur me kontributet e bëra nga punëdhënësi, ligji parashikon një periudhë maksimumi 2 vjet, që punonjësit t'i njihet e drejta e përfitimit të tyre.

Fondet e Investimit

Më 13 Dhjetor 2011, Bordi i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare miratoi licensimin dhe promovimin në publik të fondit të parë të investimeve, të menaxhuar nga Raiffeisen INVEST sh.a, si i pari fond investimi në Shqipëri.

Fondi i ri i quajtur "Raiffeisen PRESTIGJ", është fond i tregut të parasë, dhe do të investohet kryesisht në letra me vlerë të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Një nga qëllimet e Raiffeisen INVEST është edukimi i klientëve lidhur me mundësitë e reja të investimeve, në mënyrë që ata të dinë të marrin vendime mbi investimet e tyre. Raiffeisen INVEST jep një mundësi të re investimi në Shqipëri. Ne jemi të angazhuar të ofrojmë një paketë të gjerë produktesh investimi tek klientët tanë, duke tentuar të arrijmë balancën më të mirë midis riskut dhe mundësisë për të fituar.

Menaxhimi i riskut


Këshilli i Administrimit ka përgjegjësinë për kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e riskut. Këshilli i Administrimit është i angazhuar për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun si dhe të miratojë dhe implementojë procedurat e kontrollit për të reduktuar risqet deri në një nivel të pranueshëm.

Qasja e kompanisë është që risku nuk mund të eliminohet por mund të mirë menaxhohet.

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen

Bonde te Qeverisë Shqiptare

Toleranca e investitorit ndaj riskut



↑
Konservative

Objektivi i Investimit /Fokusi i Investimit

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen është i investuar kryesisht në bonde të Qeverisë Shqiptare në lekë. Nuk ka risk nga luhatja e kurseve të këmbimit. Ky fond është veçanërisht i përshtatshëm për investitorët të cilët duan të kursejnë në shuma të vogla për pensionin e tyre dhe të përfitojnë nga mundësitë e diversifikimit dhe të një kthimi të mirë nga investimi.


Të dhëna të përgjithshme mbi Fondin

Monedha	ALL
Data e krijimit	18.10.2010
Viti kontabël	01.01.2011-31.12.2011
Komisioni administrimit	3% p.a
Kthimi nga investimi	8.12 %
Kohëzgjatja	2.20
Kohëzgjatja e modifikuar	2.10


Fondi ne datën 31 Dhjetor 2011

Vlera neto e asetëve (mln)	73.87
Numri i kontribuesve	2,231

Shpërndarja e portfolit sipas maturitetit fillestar Dhjetor 2011



Cmimi i kuotes ne 2011



Një vështrim mbi Raiffeisen Bank International

Një bankë lidere në Evropën Qëndrore dhe Lindore, përfshirë Austrinë

Raiffeisen Bank Shqipëria është një degë e Raiffeisen Bank International AG (RBI), e cila e konsideron Evropën Qëndrore dhe Lindore (duke përfshirë Austrinë), si tregun e saj amëtar. Për gati 25 vjet, RBI ka funksionuar në rajonin e Evropës Qëndrore dhe Lindore (CEE), ku sot ajo mban një rrjet të ndërthurur ngushtësisht të bankave ndihmëse, të kompanive të lisingut dhe të ofruesve të shumtë të shërbimit financiar të specializuar në 17 tregje. Si një bankë universale, RBI renditet ndër bankat kryesore në rajon. Roli i fuqishëm që luan banka është mbështetur nga brandi Raiffeisen, i cili është një prej brandeve më të njohura gjerësisht në rajon. Pas rindërtimit të saj strategjik në vitin 2010, RBI e ka pozicionuar veten si një grup bankar i shitjeve me pakicë dhe i korporateve, i cili është integruar plotësisht në Evropën Qëndrore dhe Lindore. Banka jo vetëm që ka qasje të mirë ndaj konsumatorëve të shitjeve me pakicë dhe të korporatave, por gjithashtu ofron një paketë të plotë të produktit. Në fund të vitit 2011, një personel prej rreth 56.000 vetësh i shërbeu afërsisht 13.8 milionë klientëve në rreth 2.915 njësi të biznesit në Evropën Qëndrore dhe Lindore.

Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore të korporatave dhe të investimeve. Ajo u shërben kryesisht klientëve austriakë, por edhe atyre ndërkombëtarë, si dhe klientëve kryesorë shumëkombësh që veprojnë në CEE. Për më tepër, RBI është e përfaqësuar në qendrat financiare botërore dhe operon degë dhe zyra përfaqësuese në Azi. Numri total i personelit të punësuar nga RBI është rreth 59.000 vetë dhe asetit total i saj ka një vlerë prej rreth 147 miliard €.

Degët bankare të RBI-së veprojnë në tregjet e mëposhtme të CEE:

• Shqipëri	Raiffeisen Bank Sh.a.
• Bjellorusi	Priorbank, OAO
• Bosnje dhe Hercegovinë	Raiffeisen Bank d.d Bosna i Hercegovina
• Bullgari	Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD
• Kroaci	Raiffeisenbank Austria d.d
• Republika Çeke	Raiffeisenbank a.s.
• Hungari	Raiffeisen Bank Zrt.
• Kosovë	Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
• Poloni	Raiffeisen Bank Polska S.A.
• Rumani	Raiffeisen Bank S.A.
• Rusi	ZAO Raiffeisenbank
• Serbi	Raiffeisen banka a.d
• Sllovaki	Tatra banka, a.s.
• Slloveni	Raiffeisen Banka d.d
• Ukrainë	VAT Raiffeisen Bank Aval

Si kompani mëmë e këtyre bankave, përqindja e aksionve të RBI-së në këto banka arrin në, ose afërsisht 100 për qind në shumicën e rasteve.

Zhvillimi i RBI-së

RBI është themeluar në tetor të vitit 2010 përmes bashkimit të Raiffeisen International me fushat kryesore të biznesit të Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB). Pozicioni i RBI-së si një nga bankat kryesore në CEE (duke përfshirë Austrinë) u përforcua edhe më tej nga bashkimi. RBI është përfshirë në listën e bursës së Vjenës që më 25 prill 2005 (deri më 12 tetor 2010 si Raiffeisen International). Ajo është e përfaqësuar në indekse të ndryshme kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë bankat ATX dhe EURO STOXX. RZB vazhdon të mbajë shumicën e aksioneve pas bashkimit, pra rreth 78.5 për qind të aksioneve. Pjesa tjetër e mbetur e aksioneve të RBI-së, prej 21.5 për qind, ndodhen në qarkullim të lirë.

RZB u formua në vitin 1927 si “Genossenschaftliche Zentralbank” (GZB). Raiffeisen e fitoi terrenin e saj të parë në Evropën Qëndrore dhe Lindore në vitin 1987, kur ajo themeloi filialen e saj të parë në Hungari. Degë të tjera të saj janë krijuar që nga ai vit; nga viti 2000 e këtej, shtrirja e Raiffeisenit në vendet e (CEE) është arritur kryesisht duke blerë bankat ekzistuese, të cilat u shkrinë në një kompani aksionere, të cilat që nga viti 2003 deri në tetor 2010 kanë vepruar nën emrin Raiffeisen International. Raiffeisen International u përfshi në listat e bursës në prill të vitit 2005, në mënyrë që të mund të financonte zgjerimin e saj në të ardhmen në mënyrë sa më efikase. Si rrjedhojë, RBI u krijua në vitin 2010 përmes bashkimit të Raiffeisen International me fushat kryesore të biznesit të RZB.

125 vjetë të Raiffeisen në Austri

Rrënjët e forta të Raiffeisenit në Austri datojnë më shumë se 125 vjet më parë. Kooperativa e parë austriake e kreditit të Raiffeisen u themelua në Mühldorf, një fshat në Austrinë e Poshtëme, në vitin 1886. Kooperativat lokale filluan që shumë shpejtë të punonin së bashku dhe, nga ana tjetër, u themeluan kooperativat rajonale duke shënuar fillimin e krijimit të strukturës me shumë nivele të organizatës Raiffeisen. Kjo jo vetëm që ndihmoi për të forcuar pozitën e tyre në treg, por mundësoi edhe një menaxhim më të mirë dhe kontrollin e rrezikut. Shumë kooperativa të produktit dhe shërbimit u themeluan me qëllim që të rrisnin specializimin dhe integrimin e tregut. Në mes të vitit 2011, Grupi Bankar Raiffeisen Austria (RGB), grupi më i madh bankar në vend, menaxhoi depozitat e klientëve austriakë me një vlerë prej 83.8 miliardë € (duke përjashtuar krijimin e kursimeve të shoqërisë), nga të cilat rreth 50.3 miliardë € u mbajtën në depozita kursimi; duke zotëruar 32.2 për qind të tregut, RGB ka vazhduar që të zgjerojë rolin e saj si lidere në treg midis bankave austriake. RGB ka arritur të formojë një pozicion të fortë në treg përmes rritjes së furqishme organike.

Për më shumë informacion ju lutemi referojuni www.rbinternational.com and www.rzb.at.





Ne jemi të përkushtuar për të përmirësuar cilësinë e jetës duke promovuar një ambient jetese më të shëndetshëm dhe ekologjik. Projekte të sponsorizuara gjatë vitit 2011 dhe që vlejné të përmenden janë stolat në park (Shkodër) shatërvan (Vlorë), rinovimi i qendrës së Ksamilit, mbjellje e pemëve, (Sarandë), pastrimi i vijës bregdetare (Gjiri i Lazlit, Zvërnec), etj.

Rrjeti i Raiffeisen Bank SHA

Distrikti Tirana 1

"Rruga e Kavajës" Tiranë

Tel: ++355 4 2253 644/6;
++355 4 2233 396;
++355 4 2224 540
Fax: ++355 4 2230 013;
++355 4 2247 912

Distrikti Tirana 2

Kompleksi "Gintash" Laprakë, Tiranë

Tel: ++355 4 2357828

Distrikti Perëndimor

L. 4, Rr. "Skënderbej", P. 915, Durrës

Tel: ++355 52 254 95;
++355 52 25 027

L. "28 Nëntori", Berat

Tel: ++355 32 32628

Distrikti Jug perëndimor

L. "Kastrioti", Rr. "Brigada e 11 Sulmuese", Fier

Tel: ++355 34 22231;
++355 34 22282;
++355 34 22502

Distrikti Jugor

L. "11 Janari" (Qafa e Pazarit), Gjirokastrë

Tel: ++ 355 84 682 86
++ 355 84 625 97

Distrikti Verior

L. "Vasil Shanto", Rr. "Çajupi",
Hotel Rozafa, Shkodër

Tel: ++355 22 43171;
++355 22 43764

L. 5, Kukës

Tel: ++355 24 22279

Distrikti Elbasan

Blvd "Rinia", Elbasan

L. "Luigj Gurakuqi", P.18

Tel: ++355 54 42260

Distrikti Jug lindor

Shëtitore "Fan Noli", Sky Center, Korçë

Tel: ++355 82 43179

Fax: ++355 82 45870

Ju lutem vizitoni web sit-in tonë: www.raiffeisen.al

Adresa dhe Kontakte

Raiffeisen Bank International AG

§Am Stadtpark 9
1030 Vienna
Tel: +43-1-71707 0
Fax: +43-1-71707 1715
www.rbinternational.com
ir@rbinternational.com
rbi-pr@rbinternational.com

Rrjeti Bankar

Shqipëri

Raiffeisen Bank Sh.a.
European Trade Center
Bulevardi "Bajram Curri"
Tirana
Tel: +355-4-238 1000
Fax: +355-4-2275 599
SWIFT/BIC: SGSBALTX
www.raiffeisen.al

Bjellorusi

Priorbank JSC
31A V. Khoruzhey
220002 Minsk
Tel: +375-17-289 9090
Fax: +375-17-289 9191
SWIFT/BIC: PJCBY2X
www.priorbank.by

Bosnje dhe Hercegovinë

Raiffeisen BANK d.d. Bosna i
Hercegovina
Zmaja od Bosne bb
71000 Sarajevo
Tel: +387-33-287 101
Fax: +387-33-213 851
SWIFT/BIC: RZBABA2S
www.raiffeisenbank.ba

Bullgari

Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD
18/20 Ulica N. Gogol
1504 Sofia
Tel: +359-2-9198 5101
Fax: +359-2-943 4528
SWIFT/BIC: RZBBBGSF
www.rbb.bg

Kosovë

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
Rruga UÇK, No. 51
10000 Pristina
Tel: +381-38-222 222
Fax: +381-38-2030 1130
SWIFT/BIC: RBKORS22
www.raiffeisen-kosovo.com

Kroaci

Raiffeisenbank Austria d.d.
Petrinjska 59
10000 Zagreb
Tel: +385-1-456 6466
Fax: +385-1-481 1624
SWIFT/BIC: RZBHHR2X
www.rba.hr

Poloni

Raiffeisen Bank Polska S.A.
Ul. Piękna 20
00-549 Warsaw
Tel: +48-22-585 2001
Fax: +48-22-585 2585
SWIFT/BIC: RCBWPLPW
www.raiffeisen.pl

Rumani

Raiffeisen Bank S.A.
Piata Charles de Gaulle 15
011857 Bucharest 1
Tel: +40-21-306 1000
Fax: +40-21-230 0700
SWIFT/BIC: RZBRROBU
www.raiffeisen.ro

Rusi

ZAO Raiffeisenbank
Smolenskaya-Sennaya sq., 28
119002 Moscow
Tel: +7-495-721 9900
Fax: +7-495-721 9901
SWIFT/BIC: RZBMRUMM
www.raiffeisen.ru

Serbi

Raiffeisen banka a.d.
Bulevar Zorana Djindjića 64a
11070 Novi Beograd
Tel: +381-11-320 2100
Fax: +381-11-220 7080
SWIFT/BIC: RZBSRSBG
www.raiffeisenbank.rs

Slovaki

Tatra banka, a.s.
Hodžovo námestie 3
81106 Bratislava 1
Tel: +421-2-5919 1111
Fax: +421-2-5919 1110
SWIFT/BIC: TATRKBX
www.tatrabanka.sk

Sloveni

Raiffeisen Banka d.d.
Zagrebska cesta 76
2000 Maribor
Tel: +386-2-229 3100
Fax: +386-2-303 442
SWIFT/BIC: KREKSI22
www.raiffeisen.si

Republika Çeke

Raiffeisenbank a.s.
Hvezdova 1716/2b
14078 Prague 4
Tel: + 420-221-141 111
Fax: +420-221-142 111
SWIFT/BIC: RZBCCZPP
www.rb.cz

Ukrainë

Raiffeisen Bank Aval JSC
Vul Leskova, 9
01011 Kiev
Tel: +38-044-490 8888
Fax: +38-044-285 3231
SWIFT/BIC: AVALUAUK
www.aval.ua

Hungari

Raiffeisen Bank Zrt.
Akadémia utca 6
1054 Budapest
Tel: +36-1-484 4400
Fax: +36-1-484 4444
SWIFT/BIC: UBRTHUHB
www.raiffeisen.hu

Kompani Lizingu

Austri

Raiffeisen-Leasing International
GmbH
Am Stadtpark 3
1030 Vienna
Tel: +43-1-71707 2966
Fax: +43-1-71707 2059
www.rli.co.at

Shqipëri

Raiffeisen Leasing Sh.a.
Rruga Kavajës 44
Tirana
Tel: +355-4-2274 920
Fax: +355-4-2232 524
www.raiffeisen-leasing.al

Bjellorusi

JLLC Raiffeisen Leasing
31A V. Khoruzhey
220002 Minsk
Tel: +375-17-289 9394
Fax: +375-17-289 9394
www.rl.by

Bosnja dhe Hercegovina

Raiffeisen Leasing d.o.o. Sarajevo
Zmaja od Bosne bb, Building B
71000 Sarajevo
Tel: +387-33-254 354
Fax: +387-33-212 273
www.rlbh.ba

Bullgari

Raiffeisen Leasing Bulgaria OOD
Business Park Sofia
Building 7B, 4th floor
1766 Sofia
Tel: +359-2-491 9191
Fax: +359-2-974 2057
www.rlbgbg

Kazakistan

Raiffeisen Leasing Kazakhstan LLP
146, Shevchenko St., Flat 1
050008 Almaty
Tel: +7-727-3785 430
Fax: +7-727-3785 447
www.rlkz.kz

Kosovë

Raiffeisen Leasing Kosovo
Str. Agim Ramadani, No. 15
10000 Pristina
Tel: +381-38-2222 22
Fax: +381-38-2030 3011

Kroaci

Raiffeisen Leasing d.o.o.
Radnicka cesta 43
10000 Zagreb
Tel: +385-1-6595 000
Fax: +385-1-6595 050
www.rl-hr.hr

Moldavi

ICS Raiffeisen Leasing SRL
51 Alexandru cel Bun
2012 Chisinau
Tel: +373-22-2793 13
Fax: +373-22-2283 81
www.raiffeisen-leasing.md

Poloni

Raiffeisen-Leasing Polska S.A.
Ul. Prosta 51
00-838 Warsaw
Tel: +48-22-3263 600
Fax: +48-22-3263 601
www.rl.com.pl

Rumani

Raiffeisen Leasing IFN S.A .
Nusco Tower
Sos Pipera nr 42, Etaj 1A
020112 Sector 2, Bucharest
Tel: +40-21-306 9696
Fax: +40-37-287 9988
www.raiffeisen-leasing.ro

Rusi

ООО Raiffeisen Leasing
Stanislavskogo St. 21/1
109004 Moscow
Tel: +7-495-721 9980
Fax: +7-495-721 9572
www.rlr.ru

Serbi

Raiffeisen Leasing d.o.o.
Milutina Milankovića 134a
11070 Novi Beograd
Tel: +381 11 2017700
Fax: +381 11 7130081
www.raiffeisen-leasing.rs

Slovaki

Tatra Leasing s.r.o.
Hodžovo námestie 3
81106 Bratislava 1
Tel: +421-2-5919 3168
Fax: +421-2-5919 3048
www.tatraleasing.sk

Siloveni

Raiffeisen Leasing d.o.o.
Tivolska 30 (Center Tivoli)
1000 Ljubljana
Tel: +386-1-241 6250
Fax: +386-1-241 6268
www.rl-sl.com

Republika Çeke

Raiffeisen-Leasing s.r.o.
Hvezdova 1716/2b
14078 Prague 4
Tel: +420-221-5116 11
Fax: +420-221-5116 66
www.rl.cz

Ukrainë

LLC Raiffeisen Leasing Aval
Moskovskiy Prospect, 9
Corp. 5 Office 101
04073 Kiev
Tel: +38-044-590 2490
Fax: +38-044-200 0408
www.rla.com.ua

Hungari

Raiffeisen Lízing Zrt.
Hungaria krt. 40-44
1087 Budapest
Tel: +36-1-298 8000
Fax: +36-1-298 8010
www.raiffeisenlizing.hu

Kompani Leazingu për Pasuritë e
Paluajtshme

Republika Çeke

Raiffeisen Leasing Real Estate s.r.o.
Hvezdova 1716/2b
14078 Prague 4
Tel: +420-2-215116 10
Fax: +420-2-215116 41
www.realestateleasing.cz

Zyrat e përfaqësimit në Evropë

Gjermani

Zyra përfaqësuese e RBI në Fankfurt
Mainzer Landstrasse 51
60329 Frankfurt am Main
Tel: +49-69-2992 1918
Fax: +49-69-2992 1922

Francë

Zyra përfaqësuese e RBI në Paris
9-11, Avenue Franklin D. Roosevelt
75008 Paris
Tel: +33-1-4561 2700
Fax: +33-1-4561 1606

Malta

Raiffeisen Malta Bank plc
52 "Il Piazzetta" Tower Road
Sliema SLM 1607
Tel: +356-2260 0000
Fax: +356-2132 0954

Mbretëria e Bashkuar

RBI London Branch
10, King William Street
London EC4N 7TW
Tel: +44-20-7929 2288
Fax: +44-20-7933 8099

Suedi

RBI Representative Office Nordic
Countries
Drottninggatan 89
P.O. Box 3294
10365 Stockholm
Tel: +46-8-440 5086
Fax: +46-8-440 5089

Zyrat e përfaqësimit në Azi dhe SHBA

Kina

Dega e RBI në Pekin
Beijing International Club 200 2nd floor
Jianguomenwai Dajie 21
100020 Beijing
Tel: +86-10-653 23388
Fax: +86-10-653 25926

Zyra përfaqësuese e RBI në Hong Kong
Unit 2106-08, 21st Floor,
Tower One, Lippo Centre
89 Queensway, Hong Kong
Tel: +85-2-2730 2112
Fax: +85-2-2730 6028

Zyra përfaqësuese e RBI në Xiamen
Unit 01-02, 32/F, Zhongmin Building
No. 72 Hubin North Road
Xiamen
Fujian Province
361012 China
Tel: +86-592-2623 988
Fax: +86-592-2623 998

Indi

Zyra përfaqësuese e RBI në Mumbai
803, Peninsula Heights
C.D. Barfiwala Road, Andhere (W)
400 058 Mumbai
Tel: +91-22-2623 0657
Fax: +91-22-2624 4529

Korea

Zyra përfaqësuese e RBI në Kore
Leema Building, 8th floor
146-1, Soosong-dong
Chongro-ku
Seoul 110-755
Tel: +82-2-398 5840
Fax: +82-2-398 5807

Malajzi

Dega e RBI në Labuan
Suite No. 28.02, Level 28
Johor Bahru City Square Office
Tower
106-108 Jalan Wong Ah Fook
80000 Johor Bahru
Phone: +607-291 3800
Fax: +607-291 3801

Singapore

Dega e RBI në Singapor
One Raffles Quay
#38-01 North Tower
Singapore 048583
Tel: +65-6305 6000
Fax: +65-6305 6001

Vietnam

Zyra përfaqësuese e RBI në qytetin
Ho Chi Minh
6 Phung Khac Khoan Street,
Room G6
District 1, Ho Chi Minh City
Tel: +84-8-3829 7934
Fax: +84-8-3822 1318

SHBA

RB International Finance (USA) LLC
1133, Avenue of the Americas, 16th
Floor
10036 New York
Tel: +01-212-845 4100
Fax: +01-212-944 2093
<http://usa.rbinternational.com>

Zyra përfaqësuese e RBI në Nju Jork
1133, Avenue of the Americas, 16th
Floor
10036 New York
Tel: +01-212-593 7593
Fax: +01-212-593 9870

Raiffeisen Zentralbank AG

Austri

Am Stadtpark 9
1030 Vienna
Tel: +43-1-26216 0
Fax: +43-1-26216 1715
www.rzb.at

Kompani të specializuara Raiffeisen

F.J. Elsner Trading Gesellschaft m.b.H.

Am Heumarkt 10
1030 Vienna
Tel: +43-1-79 736 0
Fax: +43-1-79 736 9142
www.elsner.at

Kathrein & Co. Privatgeschäftsbank Aktiengesellschaft

Wipplingerstraße 25
1010 Vienna
Tel: +43-1-53 451 269
Fax: +43-1-53 451 233
www.kathrein.at

Raiffeisen-Leasing International Gesellschaft m.b.H.

Am Stadtpark 3
1030 Vienna
Tel: +43-1-71707 2966
Fax: +43-1-71707 76 2966
www.rli.co.at

Fjalori Raiffeisen

Kryqi Gable

Logoja ndërkombëtare e Raiffeisen është Kryqi Gable. Ai është i formuar nga kryqëzimi i dy koka kuajsh dhe origjina e tij daton shekuj më parë në traditat folklorike evropiane. Ai është simbol i mbrojtjes nga e keqja dhe rreziqeve të jetës dhe mund të haset ende në shtëpitë rurale në Evropën Qendrore. Themeluesit kishin si objektiv mbrojtjen e anëtarëve të Raiffeisen-it ndaj rreziqeve ekonomike duke u bashkuar në një kooperativë dhe zgjodhën Kryqin Gable si emblemën e mbrojtjes nën çatinë e përbashkët. Logoja ka evoluar në një markë ndërkombëtare të mirënjohur dhe përdoret gjerësisht në botë.

Grupi Bankar Raiffeisen

Grupi Bankar Raiffeisen (RBG) është grupi më i madh bankar në Austri për nga totali i aktiveve. Bazuar në shifrat për fundvitin 2009, bilanci i konsoliduar i RBG në total arriti në 260 miliard Euro. Kjo përfaqëson rreth një të katërtën e të gjithë biznesit të brendshëm bankar dhe përbën rrjetin më të madh bankar me afërsisht 2,200 pika biznesi dhe rreth 23,000 punonjës. RBG përbëhet nga Bankat Raiffeisen në nivel lokal, Bankat Raiffeisen Rajonale, në nivel krahine dhe RZB si institucion qendror. RZB vepron gjithashtu si “ndërmjetës” mes operacioneve të saj ndërkombëtare dhe RBG-së. Bankat Raiffeisen janë institucione krediti kooperative private, të cilat funksionojnë si banka me një shërbim të përgjithshëm për individë. Çdo bankë Raiffeisen krahinore është pronare e bankës rajonale Raiffeisen respektive që në tërësinë e tyre zotërojnë rreth 88% të aksioneve të RZB.

Banka Raiffeisen i ka fillimet nga iniciativa e një reformatori social gjerman Friedrich Wilhelm Raiffeisen (1818-1888), i cili me krijimin e kooperativës bankare më 1862, vuri themelin e organizimit global të shoqërive kooperative Raiffeisen. Vetëm 10 vjet pas themelimit të kooperativës bankare Austriake Raiffeisen në 1886, rreth 600 banka kursimi dhe krediti funksiononin sipas sistemit Raiffeisen në të gjithë vendin. Sipas parimit themelor të vetë-ndihmës, promovimi i interesave të anëtarëve është objektivi kryesor i politikave të tyre të biznesit

Raiffeisen Bank International

Raiffeisen International Bank AG (RBI) ka shtrirë aktivitetin e saj tregëtar në rajonet kryesore të Evropës Qendrore dhe Lindore përfshirë këtu edhe Austrinë. Në Evropën Qendrore dhe Lindore RBI operon si bankë universale që ka në vartësi një rrjet bankar, kompanish lizingu dhe disa shërbime të specializuara shërbimesh financiare në 17 vende. Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore tregëtare dhe investuese. Ajo është e pranishme edhe në qendrat financiare të botës dhe ka degët dhe zyrat përfaqësuese në Azi. Në fund të vitit 2010 rreth 60,000 punonjës ju kanë shërbyer 14 milionë klientëve në rreth 3,000 qendra biznesi. Totali i aseteve të grupit është rreth 131.2 miliard Euro.

RBI lindi nga bashkimi i Raiffeisen International Bank AG-Holding (RI), me fushat kryesore të biznesit të Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB), në vjeshtë të 2010. Duke siguruar njohjen e saj të mirë për klientët individë dhe korporatave dhe bashkimin e produkteve të RI dhe RZB, RBI ka rindërtuar veten strategjikisht si një grup bankar universal në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Deri më tani manaxhimi i

riskut dhe përmirësimi thelbësor i aksesit në tregun e kapitalit dhe të të gjithë produkteve sigurojnë që banka është e aftë të rritet akoma në të ardhmen dhe të përballojë sfidat.

Aksionet e RBI-së, të cilat janë të përfshira në ATX, Bankat e Euro DJ Stoxx dhe indekse të tjera të mëdha, janë të publikuara në bursën e Vjenës. Rreth 21.5 përqind të aksioneve mbahen nga investitorët ndërkombëtarë, kryesisht në Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA, si dhe nga ana e investitorëve privat austriakë. Aksionet e mbetura (rreth 78.5 përqind) mbahen në mënyrë indirekte nga RZB. Me të dhënat e saja afat-gjatë "A" (S&P, Fitch) dhe "A1" (Moody's), RBI është gjithashtu një lëshues i rregullt i letrave me vlerë.

RZB

Themeluar më 1927, Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB) është institucioni qendror i Austrian Raiffeisen Banking Group (RBG) dhe vepron si qendra e grupit për të gjithë grupin RZB, duke përfshirë këtu edhe RBI-në. RZB funksionon si lidhja kryesore midis Austrian Raiffeisen Banking Group dhe RBI-së, me rrjetin e saj bankar në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe disa veprimatrive ndërkombëtare.

RZB Group

Grupi zotërohet dhe drejtohet nga RZB-ja. Raiffeisen Bank International është njësia më e madhe e këtij grupi.

